

te femijëve në transmetime
esën e Autoritetit të Media
ive që prej muajit prill ka
tur në **Buletini i** shumë
mendime **Lëshillit të** për
cilave kanë **Ankesave.** Në
te drejtë të kërkojë, të het
te marrë dhe të ndajë info
dhe ide, pa asnjë lloj censu
dios, tu dhe mjeteve të tje
ikimit audioviziv apo ndo
tjetër bazuar në përzgjed
m nëse këtë e bën në kuad
timin të sundim
tave të njeriut. **MM**
me krijimin e shërbimeve

DHJETOR 2023

Përmbajtja

Hyrje	04
Statistika	06
SEKSIONI I	
Ankesa me objekt "cenimin e rregullave të etikës dhe dinjitetit"	13
SEKSIONI II	
Ankesa me objekt "cenimin e të drejtave të fëmijëve"	44
SEKSIONI III	
Ankesa jashtë juridiksionit	53
SEKSIONI IV	
Ankesa jashtë afati	57
SEKSIONI V	
Ankesa të ndryshme	60

Dy fjalë

në vend të hyrjes

Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Liria e Medias kanë rrugët e tyre të përbashkëta në një hapësirë mediatike sfiduese që shpesh tejkalon të drejtat e njeriut dhe dinjitetin e tij.

Autoriteti është "kujdestari" i kësaj hapësire publike, ku përveçse siguron transmetimin e operatorëve publikë dhe privatë, kujdeset edhe për interesin publik, për programe cilësore, për respektimin e normave ligjore dhe etike.

Mbikëqyrja e zbatimit të Kodit të Transmetimit të miratuar nga AMA për çështje që lidhen me respektimin e dinjitetit dhe të drejtave themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në programet audiovizive është kompetencë dhe detyrë e Këshillit të Ankesave.

Ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodi i Transmetimit, miratuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, sanksionon parimet themelore lidhur me respektimin e normave morale dhe etike në programet audiovizive, që i drejtohen publikut.

Këshilli i Ankesave mbështet lirinë e medias dhe misionin e saj për informimin e publikut por gjithmonë duke u bazuar në parimet themelore, që mbrojnë të drejtat e njeriut e veçanërisht që i japin përparësi interesit më të lartë të fëmijës.

Kjo është kthyer në sfidën e punës së përditshme të Këshillit të Ankesave duke u reflektuar jo vetëm në nisma ligjore dhe rishikim aktesh nënligjore sic ishte miratimi i

Kodit të Transmetimit në Korrik 2023 por edhe fushtata sensibilizuese në kuadër të edukimit mediatik për të nxitur mendimin kritik dhe konsumin e përgjegjshëm dhe aktiv të medias.

Gjashtëmujori i dytë i vitit 2023, të cilit i dedikohet Buletini i 15-të i Këshillit të Ankesave përmban më së shumti shqyrtime ankesash, ku pretendohet cënim i të drejtave të njeriut dhe etikës së komunikimit.

Gjatë vitit 2023, ku në total nga Këshilli i Ankesave u trajtuan 390 ankesa, 59,5 % e tyre pretendonin publikimin e paverifikuar të informacionit në cënim të imazhit dhe dinjitetit si dhe shkelje të së drejtës për privatësi.

Është për t'u nënvizuar fakti se ankesat e trajtuara në këtë buletin i janë nënshtruar procedurës së ndërveprimit mes Këshillit të Ankesave dhe palëve të prekura, ankuesit dhe ofruesit të shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA), përmes organzimit të seancave dëgjimore mes tyre. Kjo procedure mes Këshillit të Ankesave dhe palët e përfshira, jo vetëm është reflektuar në zgjidhjen e shpejtë të ankesave duke ndihmuar gjithë procesin e shqyrtimit por përfshirja e OSHMA-së ka bërë të mundur sensibilizimin e operatorëve audiovizivë mbi njohjen dhe zbatimin e normave dhe kërkesave ligjore të Kodit të Transmetimit dhe Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Statistika


1. Administrimi i ankesave të qytetarëve apo grupeve të ndryshme të interesit në adresë të Ofruesve të Shërbimeve Mediatike Audiovizive

Përputhur me detyrimin e vet ligjor dhe rekomandimin përkatës të Kuvendit të Shqipërisë, Këshilli i Ankesave ka vijuar të shqyrtojë ankesat e mbërritura në institucion në adresë të OSHMA-ve, bazuar në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën

e Shqipërisë", i ndryshuar, apo aktet nënligjore në fuqi.


Gjatë vitit 2023, Këshilli i Ankesave ka shqyrtuar 390 ankesa, të dërguara respektivisht:

- 89% - nga individë;
- 4.7% - nga shoqëria civile;
- 3% - nga studio ligjore;
- 2% - nga institucione;
- 1.3% - nga subjekte tregtare.



Ankesat e paraqitura kanë pasur për objekt:

- 59.5 % - shkeljen e të drejtave të njeriut dhe etikës së komunikimit;
- 16.4 % - shkeljen e të drejtave të fëmijëve, privatësisë së tyre;
- 3.6 % - komunikimet tregtare në median audiovizive;
- 13.3 % - të ndryshëm;
- 7.2 % - jashtë objektit të veprimtarisë së AMA-s, përcaktuar nga ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.



- Shkeljen e të drejtave të njeriut dhe etikës së komunikimit
- Shkeljen e të drejtave të fëmijëve, privatësisë së tyre
- Komunikimet tregtare në median audiovizive
- Të ndryshëm
- Jashtë kompetencave të AMA-s

Në kuadrin e administrimit të ankesave, Këshilli i Ankesave u ka kërkuar OSHMA-ve paraqitje pretendimesh në 12.6% të rasteve, ka konkluduar me "tërheqje vëmendjeje" në

49.2% të ankesave të administruara dhe me sanksion financiar në 6 raste. Në 20.5% të rasteve të vendimmarrjes së Këshillit të Ankesave mbizotëron liria e shprehjes.



2. Masa administrative

Gjatë vitit 2023, Këshilli i Ankesave i ka propozuar Bordit të Autoritetit të Mediave Audiovizive vendosjen e sanksionit financiar me gjobë në 6 raste. Propozime të cilat kanë marrë edhe miratimin e Bordit të AMA-s.

- Vendosje sanksioni me gjobë ndaj **një subjekti audioviziv kombëtar**, për shkelje të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228, datë 11.12.2017. (Shkelje të rënda etike gjatë një diskutimi, ashpërsia e të cilit provokohet fillimisht nga moderatorja, më pas, lejohet të bëhet agresiv dhe të degjenerojë në dhunë verbale dhe fizike (goditje me shuplakë) **(VENDIMI NR. 5, DATË 08.02.2023);**
- Vendosje sanksioni me gjobë ndaj **një subjekti audioviziv lokal**, për shkelje të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. (Shkelje të rënda etike dhe privatësie në transmetim të drejtpërdrejtë, gjatë të cilit, moderatorja njofton nënën për humbjen e jetës të së bijës, duke i lexuar mesazhin e një qytetari, dërguar në redaksi. **(VENDIMI NR. 30, DATË 25.04.2023)**
- Vendosje sanksioni me gjobë ndaj **një subjekti audioviziv kombëtar**, për shkelje të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (Publikim i përsëritur, pa paralajmërim për shikuesit dhe pa teknologji mbulimi i pamjeve të rënda dhe shumë shqetësuese të një vrasjeje, shoqëruar me komentimin në mënyrë të bujshme të gazetarit). **(VENDIMI NR. 36, DATË 02.05.2023);**

- Vendosje e sanksionit me gjobë ndaj **një subjekti audioviziv lokal**, për shkelje të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. (Provokim i shikuesve nga ana e vetë gazetarit me gjest fyes të papranueshëm, në një orar që ndiqet edhe nga të miturit.) **(VENDIMI NR. 48, DATË 05.06.2023);**
- Vendosje sanksioni me gjobë ndaj **një subjekti audioviziv kombëtar**, për shkelje të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. (Komunikim i papërshtatshëm mes pjesëmarrësve në diskutim për orarin e transmetimit, çka shoqërohet me ndikim në zhvillimin mendor, shpirtëror dhe shoqëror të fëmijëve, megjithëse formati ishte i regjistruar dhe produksioni kishte pasur mundësitë e mënjanimit të situatave të tilla.) **(VENDIMI NR. 83, DATË 26.09.2023);**
- Vendosje sanksioni me gjobë ndaj **një subjekti audioviziv kombëtar**, për shkelje të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023. (Ngritjen e figurës së ish-diktatorit dhe ish-diktaturës, përzgjedhje e njëanshme e të ftuarve, "kuriozitet fëmënor" dhe standarde të diskutueshme profesionale të gazetares, që diktojnë një mënyrë të pabalancuar trajtimi për njëren prej çështjeve më të rëndësishme të debatit publik.) **(Vendim nr.118, DATË 22.12.2023).**

a. Thirrje/Sensibilizime

3. Thirrje/Sensibilizime

Gjatë vitit 2023, Këshilli i Ankesave i ka bërë thirrje sensibilizuese OSHMA-ve në

dy raste për respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr.97/2013, i ndryshuar dhe parimeve themelore të Kodit të Transmetimit.

- (5 Qershor 2023) Një subjekti audioviziv, iu sollën në vëmendje detyrimet e OSHMA-ve për zbatim të normave dhe parimeve të Kodit të Transmetimit për respektimin e etikës së komunikimit dhe verifikimin e vërtetësisë së lajmit;
- (22 Qershor 2023) Një subjekti audioviziv, iu sollën në vëmendje normat etike dhe detyrimet e OSHMA-ve për të siguruar që trajtimi i ngjarjeve të jetë i drejtë për të gjitha subjektet e interesuara në këto çështje dhe të paraqitet në mënyrë të vërtetë dhe të paanshme (ligji nr.97/2013, i ndryshuar, neni 33, pika 1/b).

4. Tërheqje Vëmendje

Gjatë vitit 2023, Këshilli i Ankesave i ka tërhequr vëmendjen OSHMA-ve në 15 raste për shmangien e detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr.97/2013, i ndryshuar dhe parimet themelore të Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr.60, datë 10.07.2023.

- (17 Janar 2023) Një subjekti audioviziv kombëtar iu tërhoq vëmendja për cënim të rregullave të etikës dhe moralit publik përmes transmetimeve të përmbajtjeve që nxisin dhe përhapin dhunë, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 33);
- (19 Janar 2023) Një subjekti audioviziv kombëtar iu tërhoq vëmendja për paraqitjen e lajmeve të pavërteta duke disinformuar publikun, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 33, pika 1/a dhe 1/b) dhe Kodit të Transmetimit (Seksioni 4, pika 4.3 dhe 4.5);
- (19 Janar 2023) Një subjekti audioviziv kombëtar, iu tërhoq vëmendja për transmetime që nxisin dhunën dhe cënojnë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut, duke shmangur detyrimet që rrjedhin nga Ligji nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 4 /pika 2/d: 2/dh, Neni 32, pika 4, Neni 33, pika 1/ç: 1/d) dhe Kodin e Transmetimit (Seksioni 1, pika 1.5. dhe 1.6.);
- (6 Shkurt 2023) Një subjekti audioviziv, iu tërhoq vëmendja për transmetim informacioni të paverifikuar dhe disinformim, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 33, pika 1/a dhe b);
- (15 Shkurt 2023) Një subjekti audioviziv kombëtar iu tërhoq vëmendja për transmetime të përmbajtjeve audiovizive që përmbajnë gjuhë urrejtje dhe përhapin dhunë, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 4 pika 2/d dhe dh, neni 32, pika 4, neni 33 pika 1/ç dhe d) dhe Kodit të Transmetimit (Seksioni 1, pika 1.5 dhe 1.6);
- (19 Prill 2023) Një subjekti audioviziv kombëtar iu tërhoq vëmendja për transmetime që nxisin dhe justifikojnë dhunën duke shkelur rregullat e etikës dhe moralit publik, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 4, pika 2 d,dh, Neni 32 pika 4, Neni 33 pika ç,d);
- (22 Qershor 2023) Një subjekti audioviziv iu tërhoq vëmendja për transmetime të papërshtatshme dhe me përmbajtje erotike, pa siguruar mbrotjen e fëmijëve, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 33, pika e);
- (1 Nëntor 2023) Një subjekti audioviziv kombëtar iu tërhoq vëmendja për transmetime, që përmbajnë gjuhë diskriminuese dhe të papërshtatshme, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 32, pika 4 dhe Neni 33, pika ç,d);

- (6 Nëntor 2023) Një subjekti audioviziv kombëtar iu tërhoq vëmendja për transmetimin e përmbajtjeve me natyrë erotike, pa siguruar mbrojtjen e të miturve, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 33 dhe Neni 46, pika dh);
- (10 Nëntor 2023) Disa subjekteve audiovizive, dy prej të cilëve kombëtare, iu tërhoq vëmendja për shkak të cënimit të prezumimit të pafajësisë në transmetimin e lajmit në shkelje të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 4 pika ç, Neni 33, pika 4) dhe Kodit të Transmetimit (Seksioni 3, pika 3.4);
- (6 Dhjetor 2023) Një subjekti audioviziv kombëtar iu tërhoq vëmendja për transmetime që bien ndesh me detyrimet e OSHMA-ve duke cënuar dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 33).

5. Seanca dëgjimore

(Neni 52, pika 6 e ligjit 97/2013)

Në kuadrin e administrimit të një ankese në adresë të emisionit "Piranjat", transmetuar në televizionin "Syri TV" më datë 22.09.2023, me pretendimin e "deformimit të fakteve dhe dëmtimit të imazhit", bazuar në nenin 51 të Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat për shqyrtimin e

ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes", si dhe udhëzimit "Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv", Këshilli i Ankesave i kërkoi televizionit "Syri TV" fillimisht paraqitjen e pretendimeve.

Më pas, bazuar si në ankesën e paraqitur ashtu edhe në pretendimet e paraqitura nga "Syri TV", bazuar në ligjin nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 52, pika 6, Këshilli i Ankesave organizoi një seancë dëgjimore me palët, pranë zyrave të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Gjatë seancës, pas dëgjimit të pretendimeve të ankueses, përfaqësuesja e OSHMA-së nënvizoi predispozitën bashkëpunuese të OSHMA-së për ritrajtimin e çështjes. Pas seancës dëgjimore dhe rishqyrtimit të pozicioneve të paraqitura, në prani të Këshillit të Ankesave, palët u dakordësuan që ankueses t'i jepej e drejta e përgjigjes në episodet e radhës të emisionit "Piranjat".

Për sa më sipër, bazuar edhe në ligjin nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Këshilli i Ankesave e konsideroi të mbyllur administrimin e ankesës.

1

Ankesa me objekt

"cenimin e rregullave

te etikës dhe dinjitetit"

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Dëshmitarët e Jehovahit	"EuroBalkansNews"	Good Morning Albanians	18.05.2023

1. Objekti i Ankesës

Përfaqësuesit e shoqatës fetare "Dëshmitarët e Jehovahit" në Shqipëri i drejtuan Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Medias Audiovizive (AMA) një ankesë me objekt *"refuzimin e së drejtës së përgjigjes"* lidhur me deklaratat e z.P.V, i ftuar në emisionin "Goodmorning Albanians", transmetuar në "EuroNews Albania" në datën 18 maj 2023, ora 07.40, me pretendimin se deklaratat e tij ishin *"tronditëse dhe shpifëse ndaj besimit të Dëshmitarëve të Jehovahit"*.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të ankesës dhe shqyrtimit të saj, Këshilli i Ankesave konstatoi se ankesa, formuluar prej ankuesit më datë 21.06.2023 dhe marrë prej Këshillit të Ankesave më datë 22.06.2023, me objekt emisionin *"Good Morning Albanians"*, të datës 18.05.2023 rezultonte jashtë afateve ligjore për administrimin e saj, bazuar në nenin 52 *"Shqyrtimi i ankesave"*, pika 2, të ligjit nr. 97/2013 *"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, sipas të cilit *"Ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar në Këshillin e Ankesave brenda 30 ditëve nga data e transmetimit..."*.

Megjithatë, nisur nga ndjeshmëria që kishte tema për interesin publik, Këshilli i Ankesave, referuar nenit 52 *"Shqyrtimi i ankesave"*, pika 3, e ligjit nr. 97/2013 *"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, rregullores *"Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës*

së përgjigjes" si edhe udhëzimit *"Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv"*, i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave të Ofruesit të Shërbimit Mediatik Audioviziv "Euronews", paraqitjen e pretendimeve lidhur me ankesën e sipërpërmendur.

Në përgjigjen e tyre, Ofruesi i Shërbimit Mediatik Audioviziv "Euronews", pretendonte se:

- *"Ftesa për të marrë pjesë në emision "u ishte drejtuar të gjithë përfaqësuesve të komuniteteve fetare në Shqipëri, përfshirë dhe shoqatën "Dëshmitarët e Jehovahit në Shqipëri"*.
- *Është "komunikuar me z. D.M", i cili në lidhje me këtë ftesë, ka informuar, se pjesëtarët e shoqatës "nuk dëshironin të merrnin pjesë në emision". Megjithatë, "duke i konsideruar si komunitet fetar në Shqipëri" si edhe në interes të "individëve, të cilët janë pjesë e tij", është "informuar publiku për arsyet e mosprezencës" së përfaqësuesve të shoqatës në televizion.*
- *"Ankesa ... u referohet komenteve personale të njërit prej të ftuarve në emision, z. P.V... dhe televizioni nuk atashohet në asnjë moment me këtë qëndrim..."*
- *Pas mbërritjes së ankesës, kanë marrë "të gjitha masat për ta adresuar atë, duke komunikuar fillimisht me z. D.M në rrugë telefonike dhe në vijim edhe nëpërmjet adresës elektronike..., për të kuptuar situatën dhe për gjetjen e një zgjidhjeje të përbashkët. Televizioni e ka ftuar z. M.,*

përsëri për të shprehur në emision qëndrimin e tij, por ky i fundit ka refuzuar, duke komunikuar, se nuk ka asnjë pretendim ndaj televizionit, por ndaj qëndrimeve personale të të ftuarit."

- *"Euronews Albania ka marrë të gjitha masat për ta zgjidhur çështjen me mirëkuptim, duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm me përfaqësues të shoqatës, duke i kthyer përgjigje çdo pyetje.. si edhe duke iu ofruar kohë televizive për të shprehur qëndrimet dhe shqetësimet e tyre."*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të dokumentacionit vënë në dispozicion, verifikimit të pretendimeve të palëve dhe këqyrjes së përmbajtjes audiovizive përkatëse, Këshilli i Ankesave konstatoi se, në kushtet, kur ankesa ishte formalisht jashtë afateve ligjore të administrimit të saj nga Këshilli i Ankesave dhe operatori "Euronews" i kishte ofruar ankuesit kohë televizive si edhe mundësinë e pranisë/shprehjes në edicionin e sipërpërmendur dhe pas tij, në funksion të ushtrimit të së drejtës së përgjigjes "në mënyrë të ngjashme dhe me kohë të njëjtë me atë të transmetimit objekt ankese", nuk përbënte shkelje të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe as të Kodit të Transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
G. Gj	MCN TV	Të paekspozuarit	25.05.2023

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi G. Gj, përfaqësuesi ligjor i shtetasit Dh.A.B, iu drejtua Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, në lidhje me emisionin "Të Paekspozuarit", transmetuar në televizionin "MCN TV", në datën 25.05.2023. Ankuesi pretendonte se në emision ishte lejuar një gjuhë dhe një fjalor që i kishte cënuar dinjitetin dhe të drejtat themelore shtetasit Dh.A.B.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të ankesës, referuar nenit 51 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes", si dhe udhëzimit "Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv", Këshilli i Ankesave i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave të televizionit "MCN", paraqitjen e pretendimeve në lidhje me ankesën ndaj emisionit "Të Paekspozuarit" të datës 25.05.2023.

Në përgjigjen e tyre, subjekti audioviziv "MCN TV" sqaroi se:

- "Është e paqartë se çfarë shkelje konkrete është konsumuar nga ana e televizionit tonë....pa cituar konkretisht cila e drejtë themelore është cënuar nga ana jonë apo cilën vepër penale konkrete kemi nxitur.
- MCNTV nuk ka cënuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, përkundrazi i ka respektuar ato.... ka krijuar mundësinë që

një person, konkretisht z.Dh (përfaqësuesi i palës së prekur) i ftuar në emision, shpreh opinionin dhe qëndrimin e tij.

- *Dhënia e mundësisë gazetarit H., nuk do të thotë që OSHMA "MCNTV", ndan të njëjtin qëndrim apo i miraton opinionet e tij".*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadër të shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të subjektit audioviziv, Këshilli i Ankesave këqyri me vëmendje episodin e emisionit "Të Paekspozuarit", transmetuar në "MCN TV" në datën 25 Maj 2023, në orën 21:00, prej nga rezultoi se, përtej garantimit të mundësisë së përfaqësimit për palën e prekur apo respektimit të lirisë së shprehjes, përmbajtja audiovizive e shqyrtuar evidentonte shkelje të standardit të etikës së komunikimit dhe mosndërhyrjen e drejtuesit të emisionit për shmangien e tyre.

Për rrjedhojë, Këshilli i Ankesave konstatoi shmangie në zbatimin e ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar në:

- nenin 4, "Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive", pika 1/b) "veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut",
- nenin 46, "Kodi i Transmetimit", pika 2/a) "OSHMA-të të mos transmetojnë programe që cenajnë rregullat e etikës dhe moralit publik",

dhe

- *Kodin e Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023, në Seksionin 1, "Parimet themelore":*
- *pika 1.3:"Transmetimet audiovizive respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut",*
- *pika 1.5:"Transmetimet audiovizive nuk duhet të nxisin urrejtjen, intolerancën, diskriminimin".*

Në vendimmarrjen e tij, Këshilli i Ankesave i sollti në vëmendje televizionit "MCN" zbatimin e Ligjit nr.97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023 duke i kujtuar se përsëritja e shkeljeve të ngjashme do të penalizohej sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Shoqëria "FlorFarma"	Prapaskena.com	-	03.07.2023

1. Objekti i Ankesës

Shoqëria "Florfarma" i nisi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), me disa pretendime dhe kërkesa, ku ndër të tjera kërkonte:

- *"Marrjen e masave dhe fshirjen e publikimit*
<https://prapaskena.com/2023/07/03/ish-berberi-mitro-todhe-qeth-3-tenderat-e-mushkonjave-dy-femijet-jete-luksi-kane-marre-mbi-1500-tendera-nga-beqja-dhe-manastirliu-me-florfarma/>,
- *Marrjen e masave administrative sipas ligjit për publikimin e datës 03.07.2023 kundër shoqërisë "Florfarma" sh.p.k si një publikim i kryer në kundërshtim me ligjin dhe shkeljen e të drejtave themelore të njeriut duke shkelur privatësinë, dinjitetin dhe personalitetin e shoqërisë dhe anëtarëve themelues të saj",*

si dhe

- *"Hetim të plotë e të thelluar në lidhje me të dhënat e "investigimit" për shkrimin e publikuar,*

- *Fshirjen e të gjithë të dhënave personale të kompanisë, të dhënat identifikuese të administratorëve dhe ortakëve etj.,*
- *Fshirjen e të gjithë materialit ku përdoret gjuha e urrejtjes".*

2. Administrimi i Ankesës

Pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të ngritura, ankuesit iu bë me dije se Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), vepron në bazë dhe për zbatimin e Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili ka për "Fushë e zbatimit" (neni 2), "transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar". Gjithashtu ankuesi u njoftua se edhe me ndryshimet e fundit ligjore, konkretisht ligji nr.30/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë e Shqipërisë", të ndryshuar, miratuar në datën 13.04.2023 nuk preket veprimtaria e mediave online.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
S.H.	Report TV	Pa gjurmë	31.07.2023

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave i mbërriti një ankesë nga shtetasja S.V. më datë 02.08.2023 me anë të së cilës kërkohej marrja e masave kundrejt pretendimit se *"nga intervista e realizuar në 13.07.2023, në emisionin "Pa gjurmë", i gjithë diskursi ishte formuluar mbi fakte të rreme dhe denigruese për figurën time...rrëfimi i ish - bashkëshortit tim N.H nuk është vërtetuar nga televizioni "Report TV"- dhe se-" emisioni nuk ka pasur në asnjë moment aprovimin tim për të përdorur të dhënat e mia personale, foto apo çdo detaj të jetës time private...."*.

2. Administrimi i Ankesës

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s shqyrtoi përmbajtjen audiovizive të emisionit "Pa gjurmë" dhe evidentoi se:

- *"Personi në studio, i prezantuar nga moderatorja me pseudonimin A.H intervistohet me kurriz ndaj kamerave duke ruajtur identitetin e tij.*
- *Deklaratat e të intervistuarit flisnin për shtetasen S.H, duke përdorur një tjetër pseudonim për të ruajtur identitetin e*

personave të përfshirë në rrëfim (konkretisht identitetin tuaj).

- *Fotot e publikuara ishin të sfumuara, pra televizioni kishte përdorur teknologjinë e përshtatshme për mosidentifikimin dhe ruajtjen e fshehtësisë së jetës private të individit."*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Bazuar në ligjin Nr.97/2013 *"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar përcaktohet se Ofruesi i Shërbimit Mediatik Audioviziv duhet *"të mos cenojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut"*, (neni 33 pika ç) si dhe *"të mos cenojë të drejtën e fshehtësisë së jetës private të individit në çdo program të transmetuar nga OSHMA-të dhe mjetet e përdorura për të realizuar këto programe"* (neni 33, pika dh).

Sa më sipër, Këshilli i Ankesave vlerësoi se OSHMA-ja kishte zbatuar parimet që përbëjnë bazën e zhvillimit të veprimtarisë audiovizive duke u kujdesur për marrjen e masave përmes përdorimit të teknologjisë përkatëse për të ruajtur fshehtësinë e jetës private dhe identitetin e individit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
G.V.	"Top Channel"	"E Diell"	21.09.2023

1. Objekti i Ankesës

G.V i dërgoi një ankesë Këshillit të Ankesave në lidhje me rubrikën "Mos i bjer me top", të emisionit "E diell", transmetuar në televizionin "Top Channel", në datën 17 Shtator 2023. Ankuesja pretendonte se ishte publikuar një video në të cilën kishte qenë kalimtare e rastit dhe ishte përdorur imazhi i saj.

2. Administrimi i Ankesës

Pas marrjes së ankesës, në kuadrin e administrimit të saj, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), referuar nenit 51 të ligjit nr. 97/2013 "*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, rregullores "*Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes*", si dhe udhëzimit "*Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv*", i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave të "Top Channel", paraqitjen e pretendimeve.

Në përgjigjen e tyre, subjekti audioviziv "Top Channel" bëri me dije se "*Ankuesja nuk është marr në intervistë por ka qenë një kalimtare e rastit gjatë zhvillimit të një kamere të fshehtë...*".

Sipas televizionit "Top Channel", Shoqëria kishte ndërmarrë masat duke e hequr materialin nga rrjetet sociale në pjesën ku kalimtarja dukej gjatë zhvillimit të kamerës së fshehtë si dhe në YouTube ishte bërë blur imazhi i saj.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Duke vlerësuar reagimin e televizionit dhe marrjen e masave të menjëhershme për heqjen e materialit përkatës nga rrjetet sociale dhe përdorimit të teknologjisë për mbulimin e imazhit të ankueses, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s i kërkoi OSHMA-së të tregohen të kujdesshëm në respektimin e kërkesave të ligjit dhe të Kodit të Transmetimit në përmbajtjet audiovizive në të ardhmen.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
H. Gj	TV Klan	Stop	26.09.2023

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori në shqyrtim ankesën e shtetasit H. Gj mbërritur pranë AMA-s në adresë të emisionit "Stop", transmetuar në televizionin "Klan" më datë 26.09.2023. Ankuesi pretendonte se lajmi ishte paraqitur në mënyrë të pavërtetë dhe të njëanshme duke abuzuar me të drejtën e shprehjes si dhe ishte cenuar dinjiteti përmes përdorimit të fjalëve fyese në drejtim të shtetasve në gjykim.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të ankesës së sipërcituar, referuar nenit 51 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes", si dhe udhëzimit "Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv", Këshilli i Ankesave i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave të televizionit "Klan", paraqitjen e pretendimeve në lidhje me këtë ankesë.

Në përgjigjen e tyre, subjekti audioviziv "TV Klan" bëri me dije se: "Emisioni "Stop" dhe gazetarët që kanë trajtuar ankesën e ardhur në redaksi nga familja Koka, gjatë trajtimit të rasteve kanë patur të gjithë kujdesin e duhur që informacioni të jetë i saktë dhe në përputhje të plotë me dokumentat zyrtare dhe

deklarimet e vëna në dispozicion nga familja Koka, duke patur si qëllim kryesor informimin e publikut për çështjen konkrete".

Në vijim, OSHMA-ja, sqaronte se "Citimet "grabitës i pronës" janë pretendime të ngritura në procesin gjyqësor nga ankuesit dhe në asnjë rast qëndrime të gazetarit...të gjitha momentet e konfliktit të trajtuara nga STOP pasqyrohen me fakte dhe informacione të bazuara në dokumenta zyrtare, intervista dhe/apo deklarime të personave të përfshirë në çështje, apo videoregjistrime të realizuara gjatë investigimit të rastit, për referencë në minutën 41:09 të emisionit në fjalë publikohet dokument zyrtar nga gjykata në lidhje me datën dhe orën e çështjes në fjalë".

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas këqyrjes me kujdes të materialit audioviziv përkatës, Këshilli i Ankesave vlerësoi se, emisioni "Stop" i datës 26.09.2023 gjatë trajtimit të rastit të konfliktit të pronës u referohej dokumenteve zyrtare, të lëshuara nga institucionet e Republikës së Shqipërisë në realizim të misionit të gazetarisë, për informim, në lidhje me çështje që përbëjnë interes publik.

Për rrjedhojë, Këshilli i Ankesave nuk konstatoi shkelje të Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 60 datë 10.07.2023.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Dhjetëra ankues	Vizion Plus	Albano Bogdo Show	01.10.2023

1. Objekti i Ankesës

Dhjetëra ankues iu drejtuan Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive në lidhje me emisionin "Albano Bogdo Show", transmetuar në televizionin "Vizion Plus", në datën 01.10.2023. Ankuesit pretendonin se në emision kishte patur "fjalor të papërshtatshëm, gjuhë me përmbajtje seksiste, mizogjene dhe denigruese...".

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesave, Këshilli i Ankesave shqyrtoi materialin audioviziv, prej të cilit rezultoi se:

- "Emisioni "Albano Show", një format satirik, i transmetuar në datën 29 Shtator dhe ritransmetuar në 1 Tetor përmbante,

konkretisht në minutazhin (15:40) një monolog të prezantuesit, ku pretendohet se përmbante fjalor të papërshtatshëm.

- *Shkelja e referuar nga ankuesit - nuk u konfirmua dot, pasi në momentin e cituar, produktioni rezultoi të kishte përdorur masa teknike të posaçme mbulimi në zë dhe figurë".*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave çmoi se në këtë rast OSHMA-ja kishte zbatuar parimet bazë të zhvillimit të veprimtarisë audiovizive, pasi ishte kujdesur, që përmes përdorimit të teknologjisë së posaçme të mbulimit, të mbronte audiencën nga efektet, që programi mund të kishte.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
G.V	TikTok	Video	07.10.2023

1. Objekti i Ankesës

Shtetasja G.V i drejtoi një ankesë të dytë Autoritetit të Mediave Audiovizive, me kërkesën "për të hequr nga platforma "Tik Tok" dy video me imazhin tim".

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, e sqaroi ankuesen për fushën e veprimit të legjislacionit të medias.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
L.I	News 24	Me zemër të hapur	16.10.2023

1. Objekti i Ankesës

L.I iu drejtua Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive në lidhje me emisionin "Me zemër të hapur", transmetuar në televizionin "News 24", në datën 12.09.2023, në orën 12:00. Ankuesja, ndër të tjera pretendonte se:

- *"Emisioni u zhvillua në padijeninë time.. duke privuar të drejtën e replikës, pala tjetër u vetpërfaqësua.,*
- *Çështja e konfliktit të pronës... u trajtua në mënyrë sensacionale dhe të njëanshme, etj.."*

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave këqyri me vëmendje përmbajtjen audiovizive të emisionit të referuar, prej të cilit u evidentua se:

- *"Në emision trajtohej një konflikt pronësie,*
- *Ankuesja në emision kishte të pranishëm avokatin Z.I, i cili shprehu edhe pretendimet në lidhje me çështjen, (ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, (neni 33,pika b),*
- *Trajtimi i çështjes bazohej në dokumente zyrtare, të përcjella nga palët e pranishme, gjë e cila shoqërohej me opinionet e ekspertit ligjor dhe psikologut, të ftuar në studio,*
- *Kohëzgjatja e pranisë dhe përfshirja e palëve në debat garantonte që trajtimi i një çështje kaq sensitive dhe me interes publik, si e drejta e pronës, në përmbajtjen audiovizive ishte konform ligjit nr.97/2013*

"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, sipas të cilit Ofruesi i Shërbimit Mediatik Audioviziv duhet të sigurojë që "trajtimi i ngjarjeve, përfshirë çështjet, që janë tema të debatit publik, të jetë i drejtë për gjitha subjektet e interesuara ..." (neni 33/pika b),

- *Qasja, trajtimi dhe interpretimi i fakteve nga ana e formatit dhe gazetares si pjesë e kompetencave editoriale të medias dhe lirisë profesionale të gazetarit dhe për pasojë në mbrojtjen e ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, sipas të cilit "veprimtaria e transmetimeve audiovizive është e lirë" (neni 4, pika 1/a)'.*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në vendimmarrjen e tij, Këshilli i Ankesave, mbajti parasysh se:

- *"Konsumimi i së drejtës së përgjigjes sipas ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, duhej kryer në komunikim shkresor me televizionin brenda një afati 10-ditor nga data e transmetimit (neni 53, pika 5), gjë që nga komunikimi shkresor rezultoi se nuk kishte ndodhur.*
- *Komunikimi personal me moderatoren e emisionit "Me zemër të hapur" dhe persona të tjerë të përmendur në ankesë bie jashtë tagrit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, veprimtaria e të cilit bazohet në ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili ka për "Fushë e zbatimit" (neni 2), "transmetimet audiovizive*

lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre".

Bazuar në sa më sipër, Këshilli i Ankesave nuk konstatoi shkelje të Ligjit nr.97/2013 "Për

mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 60 datë 10.07.2023.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.K	TV Klan	Stop	23.10.2023

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga A.K në adresë të emisionit "Stop", transmetuar në televizionin "Klan" më datë 26 Shtator 2023, në orën 20:05, ku pretendohet se:

- *"Ishte cënuar dinjiteti,*
- *Lajmi ishte publikuar në mënyrë të pavërtetë dhe të njëanshme,*
- *Ishte ushtruar presion mbi institucionet e drejtësisë në interes të një pale të caktuar,*
- *Ishin përdorur shprehje që cënonin parimin e prezumimit të pafajësisë,*
- *Ishin përzgjedhur ekspertë të pavarur për opinione në favor të njërës palë...".*

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të ankesës, referuar nenit 51 të ligjit nr. 97/2013 *"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, rregullores *"Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes"*, si dhe udhëzimit *"Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv"*, Këshilli i Ankesave i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave të televizionit "Klan", paraqitjen e pretendimeve në lidhje me ankesën ndaj emisionit "Stop" të datës 26.09.2023

Në përgjigjen e tyre, subjekti audioviziv "TV Klan" bëri me dije se: *"Emisioni "Stop" dhe gazetarët kanë trajtuar ankesën e ardhur në redaksi. Gjatë trajtimit të rasteve kanë patur*

të gjithë kujdesin e duhur që informacioni të jetë i saktë dhe në përputhje të plotë me dokumentat zyrtare. Deklarimet e vëna në dispozicion nga ankuesi, kanë patur si qëllim kryesor informimin e publikut për çështje konkrete".

Në vijim, OSHMA-ja, sqaroi se *"Citimet "grabitës i pronës" janë pretendime të ngritura në procesin gjyqësor nga ankuesit dhe në asnjë rast qëndrime të gazetarit...të gjitha momentet e konfliktit të trajtuara nga "Stop" pasqyrohen me fakte dhe informacione të bazuara në dokumenta zyrtare, intervista dhe/apo deklarime të personave të përfshirë në çështje, apo videoregjistrime të realizuara gjatë investigimit të rastit, për referencë në minutën 41:09 të emisionit në fjalë publikohet dokument zyrtar nga gjykata në lidhje me datën dhe orën e çështjes në fjalë".*

Këshilli i Ankesave pas këqyrjes së materialit filmik përkatës vlerësoi se emisioni "Stop" i datës 26.09.2023 gjatë trajtimit të rastit të konfliktit të pronës u referohej dokumenteve zyrtare, të lëshuara nga institucionet e Republikës së Shqipërisë në realizim të misionit të gazetarisë për informim në lidhje me çështje, që përbëjnë interes publik.

Pas marrjes së ankesës ndaj emisionit "Stop", të datës 18.10.2023, Këshilli i Ankesave këqyri materialin filmik përkatës dhe evidentoi se :

- *"Trajtimi i momenteve të konfliktit të pronës bazohet në informacione dhe fakte të bazuara në dokumente zyrtare, opinione të ekspertëve ligjorë, vendime të gjykatave përkatëse,*

- *Trajtimi i rastit i shërbente informimit të opinionit në lidhje me çështje sensitive dhe që përbëjnë interes publik, si ajo e pronësisë,*
- *Citimi i shprehjes nga moderatori "grabitësi i pronës" u referohet pretendimeve të ngritura në procesin gjyqësor.*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në lidhje me pretendimin se ishin përzgjedhur ekspertë të pavarur për opinione në favor të njëjës palë, Këshilli i Ankesave i bëri me dije ankuesit, se ky lloj verifikimi, i lidhur ngushtësisht sa me thelbin e konfliktit të pronësisë, për të cilin vendos gjykata, aq edhe me politikën editoriale të OSHMA-së, paraqiste në vetvete një ndërhyrje, për të cilën bie jashtë tagrit të AMA-s.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
L.I	Syri TV	Piranjat	26.10.2023

1. Objekti i Ankesës

L.I iu drejtua Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive në lidhje me emisionin "Piranjat", transmetuar në televizionin "Syri TV", në datën 22.09.2023. Ankuesja pretendonte se :*"gazetarja ka deformuar ngjarjet dhe faktet, duke i dëmtuar imazhin"*.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesave, Këshilli i Ankesave referuar nenit 51 të ligjit nr.97/2013 *"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, rregullores *"Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes"*, si dhe udhëzimit *"Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv"*, i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave të televizionit "Syri TV" paraqitjen e pretendimeve.

Pretendimet e televizionit përkatës u paraqitën pranë AMA-s, më datë 01.11.2023.

Në vijim të trajtimit të çështjes, bazuar në ankesën e shtetasës L.I si dhe pretendimeve të paraqitura nga televizioni "Syri TV", (referuar ligjit nr.97/2013; neni 52, pika 6), Këshilli i Ankesave organizoi një seancë dëgjimore me palët, në datën 15.11.2023 ora 13:00, në zyrat e Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Gjatë zhvillimit të seancës palët ripërsëritën përballë njëra – tjetrës pretendimet e tyre, në

lidhje me çështjen e publikuar në emisionin "Piranjat", transmetuar në "Syri TV", më datë 22.09.2023.

Ankuesja i qëndroi pretendimeve të saj të mëparshme, bazuar në dokumentacionin që dispononte dhe në mënyrën e pasqyrimin të çështjes në emision.

Koordinatorja e emisionit, pas dëgjimit të pretendimeve të ankueses, sqaroi me argumente qasjen dhe mënyrën konkrete të realizimit të përmbajtjes audiovizive përkatëse, por njëkohësisht me këtë nënvizoi predispozitën bashkëpunuese të stafit të formatit dhe OSHMA-së për të rifruar hapësirë televizive në shërbim të ritrajtimit të çështjes.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në përfundim të seancës dëgjimore dhe rishqyrtimit të pozicioneve të paraqitura, në prani të Këshillit të Ankesave, palët u dakordësuan, që ankueses t'i jepej e drejta e përgjigjes në episodet e radhës të emisionit "Piranjat". Në këtë kuadër u shkëmbyen kontaktet dhe deklaruan, se për realizimin e këtij synimi do të vazhdonin komunikimin midis tyre dhe pa ndërhyrjen e Këshillit të Ankesave. Për sa më sipër, bazuar edhe në ligjin nr.97/2013 *"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, Këshilli i Ankesave e konsideroi të mbyllur administrimin e ankesës.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
I.Sh	Top Channel, MCNTV Report TV, Vizion Plus, Shqiptarja.com, GazetaTema, BalkanWeb	Kronikë	31.10.2023

1. Objekti i Ankesës

Av.I.Sh, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të I.K, iu drejtua Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, me pretendimin se në portalet; "Shqiptarja.com, Gazeta Tema, BalkanWeb, si dhe në disa kronika informative në mediat; Top Channel, MCNTV, Report TV dhe Vizion Plus, klienti i tij ishte përshkruar "duke përdorur tituj ofendues/cënues", të cilët paraqisnin "akuza të forta në drejtim të tij" ndonëse "nuk janë të shoqëruara me prova....".

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pas shqyrtimit të përmbajtjes audiovizive, evidentoi se:

- "Televizioni "Top Channel" në datën 24 Tetor 2023 në edicionet informative kishte trajtuar problematikë, përmbajtja e së cilës kishte shmangie prej ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023.
- Televizioni "MCNTV" në datën 24 Tetor 2023 në edicionet informative kishte transmetuar kronikë e cila kishte shmangie prej ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023.

- Televizioni "Report TV" në datën 24 Tetor 2023 në edicionet informative kishte transmetuar kronikë cila kishte shmangie prej ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023.
- Televizioni "Vizion Plus", Këshilli i Ankesave i kërkoi paraqitje pretendimesh lidhur me kronikat e transmetuara më datë 24 Tetor 2023. Në përgjigjen e vet, OSHMA-ja sqaroi se "lajmi rreth shtetasit rus dhe pasqyrimi i ngjarjeve të mëtejshme ka ardhur si rezultat i funksionit që ka media, atë të informimit të publikut, duke respektuar etikën gazetareske, parimet dhe legjislacionin e zbatueshëm dhe mbi burime zyrtare, e më konkretisht komunikata për shtyp e Policisë së Shtetit, publikuar në faqen zyrtare të saj". Nga shqyrtimi i materialit audioviziv nuk u konstatua shmangie e ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në vendimmarrjen e tij, Këshilli i Ankesave mbajti parasysh edhe faktin se veprimtaria e Autoritetit të Mediave Audiovizive vepron në bazë të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 2, "Fusha e zbatimit",

(ndryshuar me ligjin nr. 30/2023, datë 13.4.2023) i cili saktëson se "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar". Sa i takon pretendimit të avokatit, mbi "linqet e mediave që kishin paraqitur,

transmetuar një informacion / shpifje të tillë: si Shqiptarja.com, Gazetatema.net, Balkanweb", iu bë me dije se mediat online vijojnë të jenë jashtë objektit të veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive i cili është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve audio dhe audiovizive në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Av.V.T	News24 Abc News Syri TV Gazeta Shqiptare	Open Mirëmëngjesi me Bashkim Hoxhën	01.11.2023

1. Objekti i Ankesës

Av.V.T i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave, në lidhje me emisionin "Open", transmetuar në televizionin "News 24" më datë 26.10.2023, në orën 21:00, ku pretendonte për "*paraqitje të lajmit në mënyrë të pavërtetë...denigrimin e figurës si avokate si dhe cënimin e privatësisë referuar llogarisë personale në rrjetin social "Facebook"*.

Një tjetër pretendim i ankueses lidhej me emisionin "Mirëmëngjesi me Bashkim Hoxhën", transmetuar në televizionin "Abc News", për të cilin pretendonte se ishte "*paraqitur lajmi në mënyrë të pavërtetë dhe se denigrohej figura e saj*". Ankuesja i drejtohej edhe televizionit "Syri TV", të cilit i referohej pa specifikuar as formatin, as datën dhe as orën e saktë të transmetimit si dhe një shkrim në "Gazetën Shqiptare".

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, pasi këqyri me vëmendje përmbajtjet audiovizive në fjalë, konkretisht emisionin "Open" të transmetuar në News 24, evidentoi se:

- "*Emisioni trajtonte vendimin e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ndaj z. S.B përmes*

diskutimeve dhe opinioneve të ftuarve në studio dhe të ftuarve në Skype.

- *Trajtimi i çështjes i shërbente informimit të opinionit në lidhje me çështje sensitive dhe me interes publik, si ajo që lidhen me personazhe politike dhe figura publike.*
- *Trajtimi bazohej në informacione dhe fakte, të nxjerra nga dokumente zyrtare dhe vendime gjykatash të bëra publike, në opinione aktorësh politikë, ekspertësh ligjorë dhe analistësh të medias.*
- *Qëndrimet e të ftuarve ishin brenda kuadrit ligjor dhe Kushtetues të përdorimit të lirisë së shprehjes, ndërsa qëndrimi i drejtueses së emisionit (njëkohësisht mbartëse e qasjes editoriale të formatit) i ekuilibruar dhe në përputhje me deontologjinë e profesionit.*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të përmbajtjes audiovizive të emisionit "Open", transmetuar në televizionin "News 24", Këshilli i Ankesave e gjeti atë në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara nga neni 4 pika 1/a), b), ç) e ligjit nr. 97/2013 "*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit (Seksioni 1, pika 1.8), miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 10 datë 10.07.2023.

Në lidhje me pretendimin ndaj emisionit "Mirëmëngjesi me Bashkim Hoxhën", transmetuar në televizionin "Abc News", ankueses iu bë me dije se Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive shqyrton vetëm ankesat, të cilat i referohen transmetimit të përmbajtjeve audiovizive, duke përmendur saktësisht subjektin audioviziv, ku ishte transmetuar materiali, formatin përkatës, datën dhe orën e saktë të transmetimit.

Përkitazi pretendimeve mbi shkrimet në "Gazetën Shqiptare", sakaq, iu sqarua ankueses se portalet bien jashtë objektit të veprimtarisë së Autoritetit të Mediave

Audiovizive, i cili është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve audio dhe audiovizive në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Përkitazi pretendimeve për cenim të privatësisë referuar llogarisë, së ankueses, në rrjetin social "Facebook", sipas përcaktimeve të ligjit të sipërcituar, mediat online bien jashtë juridiksionit dhe objektit të veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive. Edhe pas ndryshimeve të fundit, të Prillit 2023, konkretisht me ligjin 30/2023 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në republikën e Shqipërisë"*, mediat online vijojnë të mbeten jashtë objektit të veprimtarisë së Autoritetit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
H.B A.A	TV Klan	Stop	01.11.2023

1. Objekti i Ankesës

A.A dhe H.B iu drejtuan Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive në lidhje me emisionin "Stop", transmetuar në televizionin "TV Klan", në datën 10.10.2023 në orën 20:05. Ankuesit pretendonin se emisioni "u kishte cenuar privatësinë duke i publikuar emrat dhe fytyrat e tyre, i kishte shqetësuar prej disa ditësh rreshtazi duke i privuar hyrjen me mjete automobilistike në banesë, të drejtë të cilën ua kishte dhënë Gjykata".

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave këqyri me vëmendje përmbajtjen audiovizive të emisionit "Stop", transmetuar në televizionin "Klan" më datë 10 Tetor 2023, në orën 20:05, prej të cilit evidentoi se:

- *"Tema e trajtuar në formatin satiro-investigativ, "Stop" pasqyronte rastin e një konflikti pronësie mes ankuesve dhe fqinjëve të tyre, në përputhje me dispozitat që ngarkon ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e*

Shqipërisë", i ndryshuar, (neni 4/1, pika a); neni 4/1, pika ç), (neni 33/1, pika b.

- *Nga raportimi mediatik rezultoi se gazetarët i referoheshin dokumenteve zyrtare, të lëshuara nga institucionet e Republikës së Shqipërisë,*
- *Përkundrejt pretendimeve të ankuesve, gazetarja nuk kishte përdor shprehje fyese apo në cenim të dinjitet, ndërsa komentet e moderatorëve mbeteshin në kuadrin e veçorive të një formati jo thjesht investigativ, por edhe satirik,*
- *Pamjet e konfliktit ishin transmetuar, duke përdorur mjetet e nevojshme të mbulimit të pamjes, në respektim të së drejtës së fshehtësisë të jetës private të individit (neni 33/1, pika dh)."*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Bazuar në sa më sipër, Këshilli i Ankesave nuk konstatoi shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 60 datë 10.07.2023.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Albanian College Tirana	Online	Peticion	10.11.2023

1. Objekti i Ankesës

Përfaqësuesit e "Albanian College Tirana" i drejtuan një kërkesë -ankesë Këshillit të Ankesave përmes së cilës kërkonin "*të largohej peticioni i publikuar në sitin "change.org"... pasi përbënte shkelje të të drejtave të individit ... si dhe dëmtonte imazhin e mësuesit të tyre*".

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadër të administrimit të shqetësimit të sipërpërmendur, Këshilli i Ankesave verifikoi shpërndarësin e këtij informacioni, nga ku rezultoi se pretendimi i tyre i referohej platformës online "change.org". Ankuesit ju bë me dije se platforma e mësipërme bie jashtë juridiksionit dhe objektit të veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive i cili është

autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve audio dhe audiovizive në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu ankuesi u informua se veprimtaria e Autoritetit të Mediave Audiovizive bazohet në ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili ka për "Fushë e zbatimit" (neni 2), "transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar".

Edhe pas ndryshimeve të fundit, të Prillit 2023, konkretisht me ligjin 30/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 97/2013 "Për mediat audiovizive në republikën e Shqipërisë", mediat online vijojnë të mbeten jashtë objektit të veprimtarisë së Autoritetit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë	Media	-	13.11.2023

1. Objekti i Ankesës

Përfaqësuesit e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë i drejtuan një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave, me pretendimin se disa emisione në media të ndryshme kishin cenuar komunitetin ortodoks dhe denigruar figurën e klerikëve ortodoksë duke prezantuar si përfaqësues të klerikëve dhe Kishës Orthodhokse një individ të quajtur N.Xh nga Elbasani, *"një laik që vetëshpallet pa asnjë të drejtë fetare dhe ligjore prift orthodhoks"*.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, i sqaroi ankuesit se në kuadër të administrimit të materialit të referuar prej tyre duhej specifikuar media, data dhe ora e saktë e transmetimit të përmbajtjes audiovizive, objekt i ankesës së tyre.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
C. B	Panorama TV, CNA Syri TV, RTSh 24, Klan News, News 24 Fax News, Ora News	Live	28.11.2023

1. Objekti i Ankesës

C.B më datë 28 nëntor 2023, iu drejtua televizioneve: Klan News, RTSH 24, News 24, Panorama TV, Ora News, Syri TV, Fax News, CNA TV dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive për dijeni, duke kërkuar ushtrimin e "të drejtës së përgjigjes", referuar nenit 53 të ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Pas përfundimit të afateve kohore të përcaktuara nga dispozita ligjore, ankuesi njoftoi AMA-n se OSHMA-të nuk i kishin dhënë të drejtën për ushtrimin e përgjigjes.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, pas përfundimit të afateve, referuar nenit 53 "E drejta e përgjigjes", i ligjit nr.97/2013, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i kërkoi OSHMA-ve paraqitjen e pretendimeve të tyre mbi refuzimin e së drejtës së përgjigjes. Pretendimet u paraqitën zyrtarisht pranë zyrave të Autoritetit.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas administrimit të përgjigjeve të sipërpërmendura dhe këqyrjes së përmbajtjes audiovizive të datës 24 nëntor 2023, në mediat përkatëse, Këshilli i Ankesave konstatoi, se:

- *"Objekt i kërkesës lidhej me një transmetim live, ku mediat në mënyrë pasive dhe të njëkohshme kishin pasqyruar një "konferencë/deklaratë për shtyp" ose "dalje për mediat."*
- *Në rastin e referuar nuk bëhej fjalë për një kronikë, lajm apo program, ku subjektet audiovizive sendërtojnë qëndrimin e tyre editorial, po për deklaratën e një pale të tretë, transmetuar prej tyre.*
- *Autori i deklaratës ishte politikan dhe e kishte bërë këtë deklaratë në selinë e subjektit politik, të cilit i takon."*

Nisur nga sa më sipër, bazuar në ligjin 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", neni 53 "E drejta e përgjigjes", pika 1, 13/b dhe 13/gj, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive nuk ishte në kushtet e ushtrimit të së drejtës së përgjigjes së ankuesit kundrejt OSHMA-ve.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.P	RTSH	Pasditja ime	29.11.2023

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i mbërriti një ankesë nga E.P, historiane dhe anëtare e Këshillit Bashkiak Tiranë, me pretendimin se në emisionin "Pasditja ime", transmetuar në "RTSH 1", më datë 29 Nëntor 2023, në orën 17:20 : "u shfaqën foto të diktatorit Enver Hoxha dhe u lëvdua kontributi i tij gjatë komunizmit".

Ankuesja shprehu indinjatën e saj "... ndaj transmetimit të fotove të diktatorit" si fyerje "ndaj viktimave dhe familjeve të viktimave të komunizmit" si dhe kërkoi shpjegim, për arsyet e paraqitjes së diktatorit dhe diktaturës "... si simbol pozitiv".

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të ankesës së sipërpërmendur, Këshilli i Ankesave:

- "Pas verifikimit të faktit, bazuar në nenin 51 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, rregulloren "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes" si edhe udhëzimin "Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv", i kërkoi nga Bordit të Shqyrtimit të Ankesave të RTSH-së, paraqitjen e pretendimeve lidhur me ankesën e sipërcituar, për të cilën, nuk pati përgjigje, ndonëse afatet ligjore parashikojnë 7 ditë (ligji 97/2013, Neni 52 "Shqyrtimi i ankesave", pika 3).

- *Mori në shqyrtim përmbajtjen audiovizive, ku evidentoi se ankesa i referohej emisionit "Pasditja ime", transmetuar në shërbimin programor tematik "RTSH1" të Televizionit Publik Shqiptar, në datën 29 Nëntor 2023, ora 17:20, ku ndër të tjera, diskutohet edhe tema "Veteranët dhe pasardhësit e LANÇ-it kujtojnë kohën e luftës", me të ftuar në studio:*
 - Prof. Dr. Hulusi Hako, (ish-debatikas, Kryetar i Organizatës Kombëtare të Veteranëve të LANÇ-it, "Nder i Kombit" i Pasardhësve të Popullit Shqiptar).
 - Qemal Bego, (ish-partizan i Brigadës X Sulmuese, Kryekëshilltar i Organizatës Kombëtare të Veteranëve të LANÇ-it, "Nder i Kombit" i Pasardhësve të Popullit Shqiptar).
 - Anila Gjokoreci, (pasardhëse (bijë) veterani dhe motër dëshmori (Viktor Gjokoreci, kryetare e Këshillit Zonal, të zonës 9-të).
- *Gjatë emisionit, drejtuesja e emisionit shfaqti në ekran foto të veteranëve me ish-diktatorin Enver Hoxha dhe zhvilloi një bisedë, komunikimi mes të cilëve shkoi deri në glorifikimin e figurës së ish diktatorit."*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në vendimmarrjen e tij, Këshilli i Ankesave mbajti në konsideratë disa fakte, ku ndër të tjera u evidentua se përzgjedhja e të ftuarve, qasja e gazetares dhe përgjithësisht mënyra e trajtimit, ishin shkelje, referuar:

- *"Ligjit nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 4, pika 1/ç); nenin 33, pika 1/b dhe nenin 46, pika 2/c, nenin 91, pika 1, po aty pika 3) si dhe nenin 118, pika 1/a.*
 - *Statutit të RTSH-së, miratuar me vendimin nr. 98/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, në nenin 2, pika 1, pika 3, pika 4, pika 5 si dhe në nenin 37, pika 1/a).*
 - *Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023, në seksionin 1, pika 1.8, seksionin 3, pika 3.16; si dhe seksioni 4, pika 4.10."*
- Këshilli Ankesave vlerësoi se:
- *"Përzgjedhja e njëanshme e të ftuarve si edhe qasja me "kuriozitet femënor" dhe standarde të diskutueshme profesionale e gazetares, diktonin një mënyrë të pabalancuar trajtimi për njërën prej çështjeve më të rëndësishme të debatit publik. Për rrjedhojë, trajtimi jo vetëm, që nuk siguron informim objektiv dhe të paanshëm, të plotë, të padiferencuar dhe të pandikuar ideologjikisht e politikisht, nuk është i drejtë për të gjitha subjektet e*

interesuara dhe nuk u shërben nevojave demokratike të shoqërisë, por madje lëndon, shqetëson ose ofendon seriozisht një numër të konsiderueshëm shikuesish, të përndjekur ose prekur direkt apo indirekt nga diktatura si edhe ndikon negativisht në edukimin e brezit të ri, një pjesë e konsiderueshme e informacionit të të cilit për atë periudhë buron nga media.

- *Provokimi i shikuesve me një trajtim të tillë, nuk ishte qasja e duhur për një shërbim audioviziv publik,*
- *Pluraliteti, diversiteti dhe debati i lirë në studion televizive, nuk mund të keqpërdoren si hapësirë për glorifikimin e ish-diktatorit dhe sistemit diktatorial,*
- *Evitimi i qasjeve të tilla nuk përbën censurë, por përgjegjësi profesionale dhe etike ndaj publikut dhe interesave të tij."*

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave, propozoi vendosjen e sanksionit financiar, i cili u miratua nga Bordi i Autoritetit të Mediave Audiovizive me vendimin nr.118, datë 22.12.2023.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Dhjetëra ankues	Top Channel	Portokalli	30.11.2023

1. Objekti i Ankesës

Dhjetëra ankues iu drejtuan Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) me pretendimin se në spektaklin e humorit "Portokalli" transmetuar në televizionin "Top Channel", në datën 26 Nëntor 2023, në orën 21:00, tek episodi "Doktori, lindje online në spitalin e Pukës", "trajtohet në mënyrë denigruese dhe tallëse shërbimi mjekësor që një qytetar pukjan merr në spital".

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të pretendimeve, Këshilli i Ankesave këqyri me vëmendje spektaklin e humorit "Portokalli" transmetuar në televizionin "Top Channel", në datën 26 Nëntor 2023, në orën 21:00 dhe evidentoi se:

- *Skeçi përmes personazheve humoristik dhe në mënyrë konvencionale krijonte situata dhe ndodhi të jetës së përditshme*

me qëllimin e vetëm, argëtimin e audiencës.

Këshilli i Ankesave vlerësoi se gjykimi i punës artistike, krijimtarisë, skeçeve apo çdo forme arti tjetër argëtues apo humoristik duhet parë edhe në një këndvështrim tjetër, përsa kohë liria për t'u shprehur dhe krijuar çdo formë arti garantohej nga Konventat Ndërkombëtare, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe nga ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave konstatoi, se përmbajtja për të cilën ishin shprehur ankesat nuk binte ndesh me kërkesat e Ligjit nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 60 datë 10.07.2023.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.D	Top Channel	Top Story	30.11.2023

1. Objekti i Ankesës

E.D i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) me pretendimin se në emisionin "Top Story", me temë "*Shqipëria, 111 vjet shtet*", transmetuar në televizionin "Top Channel", në datën 27 Nëntor 2023, në orën 21:10, një ndër të ftuarit, duke cituar ish-kryeministrin e Shqipërisë përgjatë vitit 1924, Fan Stilian Nolin, kishte përdorur shprehje diskriminuese.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të pretendimeve të ankuesit, Këshilli i Ankesave këqyri me vëmendje emisionin "Top Story", transmetuar në televizionin "Top Channel", në datën 27 Nëntor 2023, në orën 21:10, prej nga ku evidentoi se:

- *Emisioni trajtonte temën e historisë së Shqipërisë që prej themelimit të saj me disa të ftuar në studio përkatësisht,*

znj.Valentina Duka – historiane, z.Robert Aliaj – artist, z.Auron Tare – studiues dhe Z. Agron Alibali – studiues.

- *Gjatë diskutimit mes të ftuarve, njëri prej tyre citonte fjalimin e ish-kryeministrit të Shqipërisë, Fan Stilian Noli.*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave vlerësoi se terminologjia e përdorur nga të ftuarit nuk përfaqësonte qëndrimin e tyre por ishte citim i një prej pasazheve të fjalimit të shkruar të ish kryeministrit të Shqipërisë, Fan Stilian Noli.

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave konstatoi, se përmbajtja audiovizive e sipërpërmendur nuk binte ndesh me kërkesat e Ligjit Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 60 datë 10.07.2023.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
C.B	Syri TV Plug	Task Forcë	04.12.2023

1. Objekti i Ankesës

Më datë 4 Dhjetor 2023, ankuesi C.B i dërgoi një e-mail televizionit "Syri TV" në adresat përkatëse, dhe për dijëni Autoritetit të Mediave Audiovizive në (*info@ama.gov.al*), duke kërkuar ushtrimin e "të drejtës së përgjigjes", sipas nenit 53 të ligjit nr. 97/2013, pas transmetimit "në datën 29.11.2023 ... emisioni... "Plug" dhe... emisioni "Task Forcë".

Sipas ankuesit, "dy programet në 180 minuta u fokusuan duke e akuzuar atë për abuzime dhe paligjshmëri në procedurat e ndjekura për një kontratë 1 euro me Ministrinë e Ekonomisë". Përmes postës elektronike me datë 19 Dhjetor 2023, ankuesi njoftoi AMA-n se OSHMA-ja nuk i ishte përgjigjur kërkesës së tij, për të ushtruar të drejtën e përgjigjes.

2. Administrimi i Ankesës

Bazuar në nenin 51 të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes", si dhe udhëzimit "Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv", Këshilli i Ankesave i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave të televizionit "Syri TV" paraqitjen e pretendimeve të tyre lidhur me ankesën e sipërcituar, pretendime të cilat u paraqitën pranë AMA-s, më datë 23.01.2024. Në vijim të administrimit të çështjes, referuar ankesës së z.C.B si edhe pretendimeve të paraqitura nga "Syri TV", bazuar në ligjin

nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 52, pika 6, sipas së cilës "... gjatë procedurave të zgjidhjes së ankesës, Këshilli i Ankesave vendos organizimin e seancave dëgjimore me palët", Këshilli i Ankesave organizoi një seancë dëgjimore me palët.

Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, palët paraqitën edhe para njëra-tjetrës të njëjtat pretendime, si gjatë komunikimeve shkresore apo elektronike të sipërpërmendura. Këshilli i Ankesave sqaroi, se seanca synonte të verifikonte arsyet e mospërputhjes midis pozicionit të shkresës të "Syri TV", sipas së cilës "e drejta e përgjigjes" nuk refuzohet dhe perceptimit të ankuesit, z. C.B, sipas të cilit, kjo e drejtë i është refuzuar.

Ankuesi sqaroi se, "të drejtën e përgjigjes" e kërkonte si standard etiko-profesional dhe ligjor, ndërsa përfaqësuesja e "Syri TV", bazuar në ligj (nr. 97/2013) dhe rregullore (Vendimi i AMA-s, nr. 181, dt. 11.09.2017, neni 11/3), sqaroi, se "kërkesa duhet të përmbajë fakte, me të cilat provon pretendimet" dhe jo thjesht opinione.

Këshilli i Ankesave, bazuar në deontologjinë e profesionit, dispozita të tjera ligjore (97/2013, neni 4 dhe neni 33) dhe verifikimin e përmbajtjeve audiovizive të referuara (të cilat rezultojnë të pabalancuara), tërhoqi vëmendjen për detyrimin e televizionit për paraqitjen e informacionit në mënyrë të paanshme dhe të balancuar, në respekt të formimit të lirë të opinionit.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në përfundim të seancës dëgjimore, Këshilli i Ankesave i kërkoi OSHMA-së aplikimin e "së drejtës së përgjigjes" për ankuesin, z. C.B, sipas nenit 53 të ligjit nr. 97/2013 "*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.

Përfaqësuesit e OSHMA-së, përmes postës elektronike, i bënë me dije Autoritetit të

Mediave Audiovizive se "emisioni "Plug" i datës 24 Janar 2024, do të ritransmetohej më 24 shkurt 2024, ora 13:20. Pas marrjes së përgjigjes nga Syri TV.

Pas verifikimeve përkatëse dhe bazuar në ligjin nr.97/2013 "*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Këshilli i Ankesave e konsideroi të mbyllur administrimin e ankesës.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
B.C	A2CNN	Kronikë	21.12.2023

1. Objekti i Ankesës

B.C i drejtoi një ankesë OSHMA-së, "A2CNN" me pretendimin se i ishte cënuar imazhi në një kronikë informative, gjë për të cilën vuri në dijeni edhe Këshillin e Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, referuar Ligjit nr.97/2013 "*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar mbajti nën monitorim mbarëvajtjen e procesit deri në zgjidhjen e problematikës përkatëse.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.V	RTSH1	Festivalit të 62-të të Këngës në RTSH	29.12.2023

1. Objekti i Ankesës

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga A.V ndaj Radio Televizionit Shqiptar (RTSH) referuar Festivalit të 62-të të Këngës në RTSH, konkretisht natës së tretë të tij transmetuar në RTSH1, më datë 21 Dhjetor 2023 përmes së cilës pretendohet se *"sipas një skenari të paracaktuar për të mbajtur qëndrim politik në një shfaqje artistike, ishte përfshirë edhe një shprehje tipike e tribunave politike, shoqëruar dhe me një mosaprovim në masë të shikuesve në sallë"*.

2. Administrimi i Ankesës

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave referuar nenit 51 të ligjit nr. 97/2013 *"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, rregullores *"Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes"*, si dhe udhëzimit të datës 11.07.2023 *"Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv"*, Këshilli i Ankesave i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave pranë RTSH-së paraqitjen e pretendimeve lidhur me ankesën. Në përgjigjen e tyre, operatori RTSH, ndër të tjera argumentoi se *"Pjesa e evidentuar...kishte një kontekst shumë më të gjerë...dhe nuk lidhej drejtpërdrejt vetëm me një personazh të caktuar të politikës shqiptare..."*.

Këshilli i Ankesave pas monitorimit me kujdes të transmetimeve të Festivalit të 62-të të

Këngës në RTSH, transmetuar në "RTSH1" në datën 21 Dhjetor 2023, evidentoi në orën 23.20 prononcimin e humoristit, Xh. D. *"...kërkoja rrugën "S. B." dhe nuk ishte. Po më duket, se do ia vënë emrin një burgu..."*, çka nuk përkonte me pretendimin e operatorit RTSH.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga shqyrtimi i materialit audioviziv dhe pretendimeve të OSHMA-së, Këshilli i Ankesave konstatoi shmangie nga Ligji nr.97/2013 *"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, sipas të cilit:

- Neni 4, pika 1/b),
- Neni 46, pika 2/c),

si edhe

- nga Kodi i Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, date 10.07.2023, sipas të cilit (Seksioni 1, pika 1.6).

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave, bazuar në *"Rregulloren për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtën e përgjigjes"*, e ndryshuar me vendimin e AMA-s, nr.56, datë 07.07.2023, neni 6 *"Konkluzionet e Këshillit të Ankesave"*, pika 4, i tërhoqi vëmendjen Radio Televizionit Shqiptar (RTSH) për shmangie nga ligji nr.97/2013 *"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar dhe Kodi i Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s nr.60, datë 10.07.2023.

2

Ankesa me objekt

"cenimin e të drejtave

të fëmijëve"

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.Sh	TV Klan	Love Island	11.09.2023

1. Objekti i Ankesës

A.Sh i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), përmes së cilës pretendonte se në emisionin "Love Island Albania" transmetuar në televizionin "Klan" në datën 11.09.2023, në orën 19:12 ishin transmetuar "muhabete" +18, seks treshe, seks pesëshe...". Ankuesja shprehte shqetësimin se "ky emision shikohej familjarisht dhe nuk ishte etike të transmetohej një fjalor i tillë në atë orar".

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave, pasi shqyrtoi përmbajtjen audiovizive dhe evidentoi se në emisionin "Love Island Albania" të datës 11.09.2023 komunikimi mes pjesëmarrësve ishte jo etik dhe i papërshtatshëm për orarin e transmetimit duke përcjellë mesazhe jo të shëndetshme për zhvillimin fizik dhe mendor, moral, shpirtëror dhe shoqëror të fëmijëve.

Këshilli i Ankesave vlerësoi, se përmbajtja e emisionit "Love Island Albania" përbënte shkelje të rëndë të Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në:

- nenin 33, "Detyrimet e OSHMA-ve", pika 1/ç): "të mos cenohet dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut", pika 1/d): "të respektojë rregullat e etikës dhe moralit publik dhe të mos transmetojë programe që mund të nxisin vepra penale".
- nenin 46, "Kodit të Transmetimit", pika 2/c: "OSHMA-të të mos transmetojnë programe që cenohet rregullat e etikës

dhe moralit publik...", 2/dh: "OSHMA-të nuk lejohet të shfaqin programe ... që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor dhe moral të të miturve, përveç rasteve kur sigurohet, duke zgjedhur orarin e transmetimit ose ndonjë masë tjetër teknike, që të miturit normalisht nuk i shikojnë ose dëgjojnë të tilla transmetime...".

dhe

Kodin e Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023, në:

- seksionin 4, pika 4.60 "OSHMA-të kujdesen të mos lëndojnë ndjeshmëritë e publikut me standardin e etikës së komunikimit, përfshirë komunikimin e dhunshëm dhe seksist... për

shkak të modelit që ata ofrojnë për publikun dhe efektin e tyre në zhvillimin moral, mendor e fizik të fëmijëve", pika 4.69 "OSHMA-të shmangin transmetimet me përmbajtje të papërshtatshëm, transmetimet e pakontrolluara dhe të dëmshme për fëmijët", pika 4.71 "OSHMA-të detyrimisht përdorin shenja paralajmëruese për programet që transmetohen në fashën orare 06.00 – 22.00 dhe që mund të cenohet ose dëmtojnë fëmijët".

-seksionin 5, pika 5.31: "duhet të tregojnë kujdesin e duhur ndaj ndjeshmërisë të publikut dhe efekteve të programeve të tilla në zhvillimin moral, mendor e fizik të fëmijëve".

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Duke pastur parasysh se përmbajtja audiovizive e emisionit "Love Island Albania" të datës 15.09.2023 ishte në shkelje të rëndë të Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin

e AMA-s, nr.10, datë 10.07.2023, për më tepër në një format të regjistruar ku produksioni i ka pasur të gjitha mundësitë e evitimit të situatave të tilla të papranueshme si ato të sipërpërmendurat, Këshilli i Ankesave, i propozoi Bordit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, vendosjen e sanksionit financiar, i cili u miratua nga Bordi.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.R	TV Klan	"Love Island Albania"	26.10.2023

1. Objekti i Ankesës

E.R iu drejtua Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive në lidhje me emisionin "Love Island", transmetuar në televizionin "TV Klan", në datën 25.10.2023 në orën 17:00. Ankuesja pretendonte se: *"ishin transmetuar stilet e kamasutrës...në një orar që ndiqej nga shumë fëmijë..."*.

2. Administrimi i Ankesës

Pasi shqyrtoi përmbajtjen audiovizive përkatëse, Këshilli i Ankesave evidentoi se:

- *"Në emisionin "Love Island Albania" të datës 25 Tetor 2023, pjesëmarrësit gjatë një loje të organizuar në grup kishin demonstruar pozicionet e tyre të preferuara në stilet e kamasutrës,*
- *Sjelljet e manifestuara nga pjesëmarrësit në emision përmbanin mesazhe erotike përgjatë një orari që ndiqej nga fëmijët (ora 19:00),*
- *Gjatë gjithë transmetimit të përmbajtjes së mësipërmeve audiovizive mungonin shenjat*

paralajmëruese për mbrojtjen e fëmijëve.'

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave vlerësoi se përmbajtja audiovizive e mësipërme kishte shmangie nga: zbatimi i ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në:

- nenin 46, "Kodit të Transmetimit", pika 2/c; 2/dh.

Kodin e Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023, në:

- në seksionin 4, pika 4.60; pika 4.64; pika 4.66; pika 4.71.

Për sa më sipër, Këshilli i Ankesave bazuar në "Rregulloren për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtën e përgjigjes", e ndryshuar me vendimin e AMA-s, nr.56, datë 07.07.2023, neni 6 "Konkluzionet e Këshillit të Ankesave", pika 4, sipas së cilës "Këshilli i Ankesave, vendosi "Tërheqje vëmendjeje" për OSHMA-në dhe kërkoi ndreqjen e shmangies nga kërkesa ligjore përkatëse brenda një afati 30 ditor".

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Albanian Woman in Audiovisual	Vizion Plus	"Vizioni i Pasdites"	26.10.2023

1. Objekti i Ankesës

Përfaqësueset e shoqatës "Albanian Woman in Audiovisual" iu drejtuan Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive për emisionin "Vizioni i Pasdites", transmetuar në televizionin "Vizion Plus", në datën 25.10.2023 në orën 18:00. Ankueset pretendonin se njëra prej të ftuarave në studio kishte "përdorur gjuhe seksiste dhe mizogjenenë lidhje me ngjarjen e përdhunimit në Vlorë".

2. Administrimi i Ankesës

Me marrjen e ankesës, Këshilli i Ankesave shqyrtoi përmbajtjen audiovizive nga ku evidentoi se:

- *"Në studio diskutohej tema "Hapja e shtëpive publike në Shqipëri".*
- *Në panel ishin të ftuar: psikologë, avokatë, teologë dhe shkrimtarë.*
- *Në kuadër të diskutimit të temës, e ftuara avokatja, znj. V.P, ndër të tjera shprehej se: "vajzat duhet të jenë një çik më të kontrolluara kur futen nëpër lokale", "shkojnë nëpër disko nate", "meshkujt meshkuj janë",*
- *Deklarata kundërshtojë nga psikologja, por kalonte pa koment apo distancim nga ana e moderatores së emisionit.*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave vlerësoi se përmbajtja audiovizive e mësipërme dhe mungesa e reagimit apo distancimit nga ana e moderatores së emisionit ishin në shmangie nga:

Ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në:

- nenin 4, pika 1/b.

Kodi i Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023, në:

- seksionin 1, pika 1.3, pika 1.5.
- seksionin 5, pika 5., pika 5.2, pika 5.4.

Për sa më sipër, Këshilli i Ankesave bazuar në "Rregulloren për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtën e përgjigjes", e ndryshuar me vendimin e AMA-s, nr.56, datë 07.07.2023, neni 6 "Konkluzionet e Këshillit të Ankesave", pika 4, sipas së cilës "Këshilli i Ankesave, caktoi masën paralajmëruese "Tërheqje vëmendjeje" për OSHMA-në dhe kërkoi ndreqjen e shmangies nga kërkesa ligjore përkatëse brenda një afati 30 ditor".

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Urdhri i Psikologut	TV Klan	Love Island Albania	01.11.2023

1. Objekti i Ankesës

Përfaqësuesit e Urdhrit të Psikologut i drejtuan një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive në lidhje me emisionin "Love Island Albania", transmetuar në televizionin "TV Klan", në datën 25.10.2023 në orën 19:00.

Ankuesit pretendonin se në emision ka patur, një episod, një lojë të organizuar në grup *"ku pjesëmarrësit kanë manifestuar sjellje jo vetëm jashtë çdo lloj etike, por madje edhe me përmbajtje erotike"*.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Ankueseve iu bë me dije se formati për të cilin ishin ankuar, kishte tërhequr vëmendjen e

Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe Këshillit të Ankesave që në edicionet e para të tij.

Me propozim të Këshillit të Ankesave, Bordi i Autoritetit të Mediave Audiovizive i vendosi sanksion financiar TV Klan, për emisionin "Love Island Albania" (Vendimin nr.83, datë 26.09.2023).

Sakaq, në lidhje me ankesën në fjalë, përfaqësueseve të Urdhrit të Psikologut, iu bë me dije se Këshilli i Ankesave kishte vendosur tërheqje vëmendje ndaj TV Klan për shmangie prej ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Dhjetëra ankues	Top Channel	Për 'puthen	17.11.2023

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërritën dhjetëra ankesa përmes të cilave pretendohet se në emisionin "Për 'puthen" transmetuar në televizionin "Top Channel" në datën 16 Nëntor 2023, në orën 18:15 ishte përdorur gjuhë kërcënuese dhe dhunë verbale nga njëri prej protagonistëve ndërsa nuk kishte patur ndërhyrje nga ana e moderatores.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pasi shqyrtoi përmbajtjen audiovizive, evidentoi se:

- "Në emisionin "Për 'puthen" të datës 16 Nëntor 2023, në vijim të takimit njohës, që dy të rinjtë zhvilluan në mjediset e një lavazhi, njëri prej pjesëmarrësve, A., i cili dukej se kishte pasur afërsi dhe

pritshmëri të tjera ndaj G., i drejtoi asaj gishtin në mënyrë kanosëse, teksa këmbëngulte të komunikonte me të duke iu imponuar pa dëshirën e saj".

- *Moderatorja e emisionit dhe opinionistët – me një përjashtim – e kaluan situatën pa koment apo ndërhyrje nga ana e tyre."*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave vlerësoi se komunikimi i mësipërm kishte shmangie nga Ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 4, pika 1/b); po aty pikat 2d), 2dh); si dhe në Kodin e Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023, në Seksionin 5, pika 5.1), në përfundim të së cilës vendosi "Tërheqje vëmendjeje".

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
J.L	Top Channel	Më lër të flas	20.11.2023

1. Objekti i Ankesës

J.L i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) në lidhje me emisionin "Më lër të flas", transmetuar në televizionin "Top Channel" në datën 18 Nëntor 2023, në orën 21:00. Ankuesi pretendonte se ishin trajtuar në mënyrë të turpshme dhe në kundërshtim me të gjitha normat etike çështje te seksit si "orgazma e raportet seksuale në 'prime time", në një orar që ndiqet nga fëmijët pa përdorur asnjë sinjal përkatës në ekran.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të pretendimeve, Këshilli i Ankesave këqyri me vëmendje përmbajtjen audiovizive të emisionit "Më lër të flas", transmetuar në televizionin "Top Channel" më datë 18 Nëntor 2023, në orën 21:00 dhe evidentoi se:

- "Që në nisje të emisionit në ekran shfaqej paralajmërimi : "Programi që do të ndiqni përmban humor dhe skena të rikrijuara nga jeta reale dhe ka për qëllim vetëm argëtimin. Çdo ngjashmëri me personazhe të vërtetë është e rastësishme. Në disa raste përmbajtja mund të jetë jo e përshtatshme për çdo audiencë!"

- Në studio diskutohej rreth përfundimeve të studimit me titull "Të rinjtë e sotëm, më pak seks se prindërit!", me pjesëmarrës në panel: Zhaklin Lekatari (gazetare), Xhuljana Nura (sipërmarrëse), Ervin Dani (mjek androlog), Amber Candy (blogere); pjesë e emisionet ishin edhe deklaratat e mjekes gjinekologe dhe sociologe.
- Si nën çështje diskutoheshin medikamentet që përdoren për problemet seksuale, kultura seksuale e shqiptarëve krahas kulturës europiane e konkretisht asaj finlandeze, marrëdhëniet seksuale të të rinjve në shoqërinë shqiptare, edukimi seksual i fëmijëve dhe të rinjve në shoqërinë tonë, nudizmi dhe kompleksiteti i shqiptarëve për çështje që lidhen me seksin."

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave vlerësoi se komunikimi i mësipërm kishte shmangie nga Ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 4, pika 1/b) si dhe në Kodin e Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.60, datë 10.07.2023, në Seksionin 5, pika 5. 1), në përfundim të së cilës vendosi "Tërheqje vëmendjeje".

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.H	Top Channel	Portokalli	17.12.2023

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) shqyrtoi ankesën e A.H në lidhje me pretendimin se në spektaklin e humorit "Portokalli", transmetuar në televizionin "Top Channel" më datë 17.12.2023 në orën 21:00, ishte përdorur fjalor banal dhe i papërshtatshëm për fëmijët.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të ankesës, referuar nenit 51 të ligjit nr. 97/2013 "*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, rregullores "*Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes*", si dhe udhëzimit "*Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv*", Këshilli i Ankesave iu drejtua televizionit Top Channel me kërkesën për paraqitje pretendimesh.

Në përgjigje të kërkesës për paraqitje pretendimesh të Këshillit të Ankesave të Autoritetit të Mediave Audiovizive, televizioni Top Channel, argumentoi se:

- "*numri në fjalë ironizon shtresat e kriminelëve, imoralëve apo të çfarëdo lloj kategorie tjetër duke i vënë në lojë për mënyrën si sillen me njëri tjetrin dhe se si bien në grackat e njëri tjetrit,*

- *në numër nuk ka asnjë glorifikim apo ngritje në pedestal të figurave të tyre,*
- *përsa i përket zhargonit të përdorur në numër, është një gjuhë që rëndom përdoret në përditshmëri, duke ironizuar kështu një pjesë të realitetit nëpërmjet humorit....".*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në vendimmarrjen e tij, Këshilli i Ankesave mbajti në konsideratë edhe formatin televiziv të cilit i referohej ankesa prej nga ku evidentoi se, përmbajtja audiovizive ishte një skeç i cili përmes dialogut satirik të personazheve tentonte të vinte në lojë dhe demaskonte fenomenin.

Këshilli i Ankesave vlerësoi se gjykimi i punës artistike, krijimtarisë, skeçeve apo çdo forme tjetër arti, argëtues apo humoristik, duhej parë edhe në një këndvështrim tjetër për sa kohë përcjell mesazhe shumë domethënëse që shërbejnë si denoncim ndaj fenomeneve të tilla.

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave konstatoi se, përmbajtja së cilës i referohej ankesa nuk binte ndesh me kërkesat e ligjit nr. 97/ 2013 "*Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 60 datë 10.07.2023.

3

Ankesa jashtë

juridiksionit

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
F.N	Pamfleti.net BoldNews.al Prapaskena.com	-	23.06.2023

1. Objekti i Ankesës

F.N i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave përmes së cilës ankohej në lidhje me publikimin e disa shkrimeve që cenonin nderin dhe dinjitetin e saj dhe të shoqërisë "NRG" sh.p.k të cilën përfaqësonte, tek disa shkrime në portalet "Pamfleti.net, BoldNews.al, Prapaskena.com".

2. Administrimi i Ankesës dhe qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës dhe duke vlerësuar ndjeshmërinë e ankueses në fjalë, Këshilli i Ankesave e informoi se Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), vepron në bazë dhe për

zbatimin e Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili ka për "Fushë e zbatimit" (neni 2), "transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar".

Gjithashtu, ankueses iu bë me dije se edhe Ligji nr.30/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë e Shqipërisë", të ndryshuar, miratuar në datën 13.04.2023 nuk e prek veprimtarinë e mediave online, për rrjedhojë kërkesa e saj binte jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Z.N	Saranda Web	-	22.08.2023

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave mori një ankesë nga shtetasi Z.N në lidhje me një lajm të pavërtetë të publikuar në portalin Saranda Web në datën 22.08.2023 duke kërkuar fshirjen e materialit nga portali përkatës.

2. Administrimi dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave e gjeti atë jashtë fushës së zbatimit të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Ankuesit iu bë me dije se Autoriteti i Mediave Audiovizive vepron në bazë të ligjit Nr. 97/2013 dhe si objekt të tij ka transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj nuk vepron për median e shkruar.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
G.A	Top Channel/You Tube	-	31.08.2023

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave mori një ankesë nga shtetasja G.A në lidhje me promovimin e cigareve elektronike "Vapes" në faqen zyrtare në YouTube të operatorit audioviziv "Top Channel" në datën 31.08.2023. Ankuesja kërkonte marrjen e masave përkatëse për shkelje të detyrimeve ligjore duke promovuar produkte të ndaluara.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes dhe shqyrtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave e gjeti atë jashtë objektit të punës së KA-së dhe trajtimin e saj e vijoi Drejtoria Ligjore pranë AMA-s.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
S.L	Kompania "One"	-	04.09.2023

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s i mbërriti një ankesë nga shtetasi S.L i cili ankohej në lidhje me mosrespektimin e kontratës lidhur mes tij dhe kompanisë "One" duke kërkuar ndërhyrjen e autoritetit.

2. Administrimi & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes dhe shqyrtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave e gjeti atë jashtë objektit të punës së KA-së duke e referuar atë pranë Drejtorisë Ligjore dhe Drejtorisë së Inspektimit dhe Mbikëqyrjes të cilat vijuan trajtimin e saj.

4

Ankesa jashtë afatī

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.SH	Top Channel	"Pop Culture"	17.06.2023

1. Objekti i Ankesës

A.SH iu drejtua me një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive më datë 17 qershor 2023, në lidhje me emisionin "Pop Culture", me titull "Erion Veliqaj në "Një ditë me Dojnë", transmetuar në televizionin Top Channel, në datën 15.09.2018, me pretendimin se i ftuari në këtë emision, Erion Veliqaj kishte përdorur fjalor fyes ndaj të rinjve shqiptarë.

Ankuesi kërkonte heqjen e videos nga kanali zyrtar i operatorit përkatës në YouTube si dhe detyrimin e Kryetarit të Bashkisë për të kërkuar ndjesë.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës dhe verifikimeve të kryera, Këshilli i Ankesave sqaroi ankuesin se data e transmetimit të përmbajtjes në fjalë binte jashtë afateve të trajtimit të saj.

Sa më sipër ankuesit iu bë me dije se në lidhje me origjinën audiovizuale të publikimeve në YouTube (transmetimin e tyre në Top Channel), bazuar në ligjin nr. 97/2013, "*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, "*Ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar në Këshillin e Ankesave brenda 30 ditëve nga data e transmetimit, ose kur në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëri-tjetrin, nga data e transmetimit më të vonë*" (neni 52, "Shqyrtimi i ankesave"), dhe si pasoje, kërkesa bie jashtë afateve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
M.H	YouTube	Video	31.10.2023

1. Objekti i Ankesës

M.H iu drejtua me një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive me datë 31 tetor 2023, me pretendimin se në vitin 2018 gjatë pjesëmarrjes në emisionin "Just Dance", transmetuar në televizionin "Top Channel", vijonin të ishin të pranishme në platformën e shpërndarjes së videove "YouTube" disa pamje të saj.

Ankuesja kërkonte heqjen e disa videove nga YouTube.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave sqaroi ankuesen se përmbajtja audiovizive për të cilën ankohej ishte jashtë afateve të parashikuara ligjore bazuar në ligjin nr. 97/2013, "*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar. (neni 52, "Shqyrtimi i ankesave").

5

Ankesa të ndryshme

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
RTSH	"RTSH"	"Mirëmëngjesi Shqipëri"	19.07.2023

1. Objekti i Ankesës

Radio Televizioni Shqiptar i drejtoi një shkresë Autoritetit të Mediave Audiovizive ku i kërkonte vlerësimin nga ana e autoritetit të përmbajtjes audiovizive të emisionit "Mirëmëngjesi Shqipëri" nëse përmbante reklamë të fshehur, sipas përcaktimeve të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së kërkesës dhe shqyrtimit të përmbajtjes audiovizive, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive evidentoi se përmendja e shkollës nga i ftuari, z.E.H., vinte si shembull ilustrues në shërbim të argumentit më shumë sesa një komunikim me

natyrë tregtare të fshehur, referuar ligjit nr.97/2013, neni 3, pika 7 i cili përcakton se *"Komunikim i fshehtë audioviziv me natyrë tregtare" është paraqitja me fjalë ose figurëtë një prodhuesi mallrash ose ofruesi shërbimesh, në programe, kur një paraqitje e tillë, nga ofruesi i shërbimit të mediave, ka për qëllim të shërbejë si reklamë dhe mund të mashtrrojë publikun mbi natyrën e tij. Një paraqitje e tillë konsiderohet se ka për qëllim të shërbejë si reklamë, kur bëhet kundrejt pagesës ose përfitimeve".*

Për sa më sipër, Autoriteti i Mediave Audiovizive vlerësoi se një deklaratë e tillë e ishte bërë brenda kontekstit të bisedës dhe pyetjes së moderatorit dhe se nuk përbënte komunikim të fshehtë audioviziv me natyrë tregtare.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
KSHH	-	-	14.08.2023

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë AMA-s i mbërriti një kërkesë nga Këshilli Shqiptar i Helsinkit në kuadër të zbatimit të nismës "Kundër Gjuhës së Urrejtjes në Ballkanin Perëndimor" në lidhje me :

- *Evidentimin e rasteve të përdorimit të gjuhës së urrejtjes, gjatë periudhës 2021-2023.*
- *Rastet e ankesave të adresuara nga qytetarët, për përdorim të gjuhës së urrejtjes gjatë periudhës 2021-2023.*
- *Masat administrative për shkelle të lidhura me gjuhën e urrejtjes, gjatë kësaj periudhe kohore.*
- *Nëse ka propozime për ndryshim legjislativ apo reformimin atij ekzistues.*
- *Nëse ishin evidentuar raste të referuara, si të kryera në kushtet e përdorimit të gjuhës së urrejtjes me sfond fetar në formën e denigrimit, stereotipizimit dhe stigmatizimit.*

2. Administrimi i Ankesës

Në përgjigje të interesit të Këshillit Shqiptar të Helsinkit, drejtuar Këshillit të Ankesave pranë AMA-s, KSHH-ja u sqarua bazuar në ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, mbi funksionimin e Këshillit të Ankesave, i cili rregullohet nga neni 20, pika 2, si strukturë "për mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit të Transmetimit dhe rregulloreve të miratuara nga AMA, që kanë të bëjnë sidomos me respektimin e dinjitetit e të drejtave të tjera

themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e të miturve, të drejtës për informacion dhe sensibilizimit të opinionit publik, lidhur me respektimin e normave morale dhe etike në programet e ofruesve të shërbimeve audiovizive".

Po kështu, iu bë me dije se një ndër funksionet e Këshillit të Ankesave lidhet edhe me shqyrtimin e ankesave sipas neneve 51, 52 dhe 53 të Ligjit nr. 97/2013. (neni 20, pika 3/b). Sa më sipër, i bëri me dije KSHH-së se gjatë periudhës 2021-2023, nga Këshilli i Ankesave pranë AMA-s ishin trajtuar 7 ankesa me objekt pretendues "gjuhë urrejtje".

Vendimmarrja e KA/AMA bazohet në ligjin nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar Kodin e Transmetimit dhe rregullore.

Nga shqyrtimi rast pas rasti i përmbajtjeve audiovizive të referuara nga ankuesit me pretendimin se kishin "gjuhë urrejtjeje", jo në të gjitha rastet kanë rezultuar të tilla.

Gjatë vitit 2021 u referuan disa ankesa, nga shqyrtimi i të cilave nuk patën shkelle, por KA/AMA, u tërhoqi vëmendjen Operatorëve të Shërbimit Mediatik Audioviziv për më shumë kujdes dhe përgjegjshmëri në paraqitjen e përmbajtjeve audiovizive audiencës.

Nga ankesat e referuara, gjatë vitit 2022 u konstatua se gjatë një debati televiziv njëri prej pjesëmarrësve ishte përdorur gjuhë urrejtje, gjë e cila nuk ishte kundërshtuar apo distancuar as nga drejtuesi i emisionit. Në

lidhje me këtë rast, KA i propozoi Bordit të Autoritetit të Mediave Audiovizive vendosjen e sanksionit financiar, masë e cila u miratua, vetë OSHMA-ja nuk e kundërshtoi.

Po, gjatë vitit 2022 u referua një ankesë me pretendimin se ishte përdorur "gjuhë urrejtje", por nuk rezultoi e tillë. Sakaq, gjatë vitit 2023 nga ankuesit u referua një rast i përdorimit të shprehje diskriminuese në një program televiziv, u vendos "Tërheqje vëmendje".

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.P	"MNCTV"	Reportazh	10.10.2023

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi A.P i drejtoi një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive, në lidhje me pretendimin se në banesën e tij ishin futur disa gazetarë të televizionit MCN pa miratimin e tij dhe kishin realizuar një intervistë me një grua të moshuar të cilën më pas e kishin publikuar. Ankuesi kërkonte fshirjen e videos dhe procedimin e gazetares.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, e sqaroi ankuesin për fushën e veprimit të legjislacionit të medias si dhe i kërkoi atij plotësimin e të dhënave për vijimin e shqyrtimit të mëtejshëm të problematikës.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN)	-	"6+1 Vlorë TV"	26.10.2023

1. Objekti i Ankesës

Përfaqësueset e shoqatës "Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri" (AWEN), iu drejtuan Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive në lidhje me një shkrim/artikull, sipas tyre "*diskriminues dhe denigrues, në adresë të gazetares A.H, publikuar në datën 24 Tetor 2023 nga 6+1 Vlorë TV, ku krahas shumë fjalëve fyese dhe denigruese, është përdorur ... 11 herë etiketim fyese*".

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pasi shqyrtoi materialin e referuar, konstatoi se objekti i ankesës ishte jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ankuesve iu bë me dije se veprimtaria e Autoritetit të Mediave Audiovizive bazohet në Ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili ka për "Fushë e zbatimit" (neni 2), "*transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre*". Edhe pas ndryshimeve të fundit, të Prillit 2023, konkretisht me ligjin 30/2023 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 97/2013 "Për mediat audiovizive në republikën e Shqipërisë"*, mediat online mbeten jashtë objektit të veprimtarisë së Autoritetit.

Në zbatim të dispozitës ligjore të sipërpërmendur, Autoriteti i Mediave Audiovizive shqyrton vetëm ankesat, të cilat i referohen transmetimit të përmbajtjeve audiovizive, referuar subjektit audioviziv, datës dhe orës së saktë të transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.R	Ora News	-	01.11.2023

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi E.R i drejtoi një kërkesë-ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive, në lidhje me kontratën e tij të punës dhe disa pretendime ndaj subjektit audioviziv "Ora News".

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, e sqaroi ankuesin për fushën e veprimit të legjislacionit të medias, konkretisht Neni 19 "Funksionet e AMA-s" (*ndryshuar shkronja "j" e pikës 1, shkronja "d" e pikës 2, shtuar shkronja*

"ë" e pikës 2 dhe pika 18 me ligjin nr. 30/2023, datë 13.4.2023) i ligjit nr.97/2013 "Për mediat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Ankuesit iu sqarua se në asnjë nga nenet e këtij ligji dhe akteve të tjera nënligjore, që rregullojnë funksionimin e këtij institucioni nuk parashikohet që AMA të ndërhyjë në marrëdhëniet kontraktuale midis subjekteve të saj apo dhe marrëdhëniet kontraktuale mes subjekteve dhe të punësuarve të tyre.

Këto marrëdhënie rregullohen në rrugë administrative, nga Kodi I Punës, Kodi Civil dhe akte të tjera ligjore, për shkeljen e të cilave janë kompetente gjykatat e Republikës së Shqipërisë.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
B.Sh	Mediat online	Shkrime	08.11.2023

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi B.Sh i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, me pretendimin se në 7 Nëntor 2023 "mediat online si "Shqiptarja.com", "Balkanweb.com" etj., kishin keqpërdorur termat "Kryetari i Bashkisë Himarë" në vend të "kandidati zgjedhor nën hetim i shpallur nga KQZ me më shumë vota në zgjedhjet vendore të 2023".

Ankuesi i referohej një artikulli për z.F.B i cili "është person nën hetim nga institucionet ligj zbatuese të Republikës së Shqipërisë...dhe prezumohet i pafajshëm deri sa të shpallet vendimi i gjykatave shqiptare, por për sa kohë nuk është bërë betimi si kryetar bashkie përpara këshillit bashkiak përkatës nuk mund të quhet kryetar".

Ai pretendonte se, materialet në fjalë ishin përcjellë edhe nëpërmjet mediave përkatëse audiovizive, si Report TV, News 24,etj.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, i bëri me dije ankuesit se:

- "Sa i takon pretendimeve të tij ndaj mediave online si "Shqiptarja.com", "Balkanweb.com" etj., u sqarua se Autoriteti i Mediave Audiovizive është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse në territorin e

Republikës së Shqipërisë veprimtaria e të cilit bazohet në Ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili ka për "Fushë e zbatimit" (neni 2), "transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar".

- Sipas përcaktimeve të ligjit të sipërcituar, mediat online bien jashtë objektit të veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive. Edhe pas ndryshimeve të fundit, të Prillit 2023, konkretisht me ligjin 30/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 97/2013 "Për mediat audiovizive në republikën e Shqipërisë", mediat online bien jashtë objektit të veprimtarisë së Autoritetit.
- Në lidhje me pretendimin e tij, se përmbajtja e mësipërme ishte përcjellë edhe nëpërmjet mediave audiovizive si Report TV, News 24,etj, pa specifikuar programin përkatës ndaj të cilit ankohej, iu sqarua se në zbatim të Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, AMA shqyrton vetëm ankesat, të cilat i referohen transmetimit të përmbajtjeve audiovizive, saktësisht subjektit audioviziv ku është transmetuar materiali, programit, datës dhe orës së saktë të transmetimit.

Sa më sipër, iu kërkua specifikimi i Programit ku ishte transmetuar materiali objekt i ankesës së tij.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.D	TV Klan	Stop	14.11.2023

1. Objekti i Ankesës

E.D i drejtoi një kërkesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive për t'i vënë në dispozicion përmbajtjen audiovizive të emisionit "Stop", transmetuar në televizionin "Klan", në datën 02.11.2023.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, i kërkoi Drejtorisë së Inspektimit dhe Mbikëqyrjes në AMA, pajisjen me një kopje të përmbajtjes audiovizive të këtij programi.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Majfis Company Sh.p.k	Syri TV	Piranjat	16.11.2023

1. Objekti i Ankesës

Përfaqësuesit e kompanisë "Majfis sh.p.k", vunë në dijeni Këshillin e Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive në lidhje me një ankesë që i kishin drejtuar "Syri TV" mbi një intervistë të panjoftuar, marrë nga gazetarët e emisionit "Piranjat".

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, referuar Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar mbajti nën monitorim mbarëvajtjen e procesit deri në zgjidhjen e problematikës përkatëse.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
B.Sh	Media	Kronika/Shkrime	16.11.2023

1. Objekti i Ankesës

B.Sh i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive me pretendimin se *"në të gjithë mediat audio dhe audiovizive ka keqpërdorim të termave duke sjellë kuptim tjetër të situatës"*.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadër të trajtimit të ankesës por edhe të ndërgjegjësimit mbi funksionet e Autoritetit të Mediave Audiovizive, Këshilli i Ankesave i bëri me dije ankuesit se monitorimi dhe shqyrtimi i përmbajtjeve të transmetuara audiovizive bazohet në kërkesat e ligjit nr.97/2013, i ndryshuar, në kërkesat e Kodit të Transmetimit, si aktet e tjera nënligjore në fuqi.

Sakaq, në lidhje me ankesë-kërkesën e tij, se: *"AMA duhet të mbikëqyrë edhe përdorimin e gjuhës shqipe në formën e duhur sipas standardit, jo vetëm të merret me kontekstin e programeve nëse ka ofendime/abuzime etj., pasi përhap konfuzion tek shikuesi mbi formën e përdorimit të shqipes sipas standardit të gjuhës"*, ankuesit iu bë me dije se në procesin e

monitorimit dhe shqyrtimit të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të, Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA, i është rikthyer dhe çështjeve të respektimit të standardit të shqipes së folur dhe të shkruar nga redaksitë audiovizive.

Autoriteti ka evidentuar dhe tekste (informacione, tituj, titrat e përkthimeve etj.) të cilat shkruhen me nxitim, duke mos respektuar as rregullat bazë të standardit të shqipes. Kjo bie në kundërshtim me zbatimin e parimeve themelore dhe kërkesave të ligjit 97/2013, neni 4, "Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive", dhe të Kodit të Transmetimit të AMA-s, seksioni 1, "Parimet themelore", të cilat përcaktojnë detyrimin e OSHMA-ve për përdorimin e standardit letrar të gjuhës shqipe.

Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga dispozitat ligjore, AMA, në cilësinë e autoritetit rregullator i bëri me dije ankuesit se, do të vijojë monitorimet mbi përdorimin e gjuhës shqipe duke e vlerësuar këtë aspekt me shumë rëndësi në edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për respektimin e standardit në të folur dhe në të shkruar.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
K.M	News 24	Open	17.11.2023

1. Objekti i Ankesës

K.M. i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive në lidhje me emisionin "Open", transmetuar në televizionin "News 24", në datë 16 Nëntor 2023 në orën 21:00, me pretendimin se:

- në këtë emision përveç deklaratave përçarëse nga ekstremistë radikalë shkuan deri aty sa dhe u kërcënua tërësia territoriale e shtetit Shqiptar,
- deklarata që sjellin ndasi dhe ku kërcënohet shteti Shqiptar nga një shtet i huaj në një televizion kombëtar,
- programe... promovojnë sensacionalitetin me personazhe ekstremiste dhe radikale duke lënë mënjanë moralitetin dhe detyrën që kanë për mirinformim të ç'do debati në mënyrë konstruktive.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të trajtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave këqyri me vëmendje përmbajtjen audiovizive të emisionit "Open", transmetuar në televizionin "News 24" më datë 16 Nëntor 2023, në orën 21:00 prej nga ku evidentoi se:

- "Në studio diskutohej tema "Beleri", Greqia ngrin negociatat e Shqipërisë", me pjesëmarrës në panel; z.Stavri Marko (gazetar), z.Fatos Lubonja (publicist), z.Fitim Zekthi (analist, Pedagog i Shkencave Politike) z.Ervis Iljazaj (analist, Pedagog i Shkencave Politike) po kështu përmes lidhjes direkte nga jashtë studios, z.Ardit Bido (Profesor i Asociuar në Marrëdhënie

Ndërkombëtare, Drejtor i Përgjithshëm i Arkivave),

- Si nën çështje diskutohej refuzimi, i pretenduar, i Greqisë për të firmosur një letër ku i kërkohej KE hapja e 5 kapitujve të parë të negociatave me Shqipërinë. Lajm i publikuar nga mediat greke dhe "Euroactiv", ka patur reagime nga kancelari gjerman z.Olaf Schulz dhe kryeministri i Shqipërisë, z.Edi Rama,
- Në hapje të debatit, moderatorja, znj.Eni Vasili shtronte pyetjet rreth marrëdhënieve Shqipëri-Greqi, dhe nëse çështja "Beleri" i tensiononte ato, duke iu dhënë hapësirë televizive pjesëmarrësve të shprehnin mendimet e tyre,
- Gjatë diskutimit në studio z.Fatos Lubonja dhe z.Stavri Marko kishin parashtruar teza, të cilat u sqaruan nga z.Ardit Bido (në cilësinë e profesorit të Asociuar në Marrëdhënie Ndërkombëtare, Drejtor i Përgjithshëm i Arkivave), teksa u kundërshtuan edhe nga penalistët e tjerë, z.Zekthi dhe z.Iljazaj.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave konstatoi, se:

- Përfshirja e palëve në debat bënte që trajtimi i një çështje kaq sensitive dhe me interes publik, si marrëdhëniet Shqipëri – Greqi dhe procesi i negociatave me BE, në përmbajtjen audiovizive të referuar, të ishte konform ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, sipas të cilit Ofruesi i Shërbimit Mediatik Audioviziv

duhet të sigurojë që "trajtimi i ngjarjeve, përfshirë çështjet, që janë tema të debatit publik, të jetë i drejtë për gjitha subjektet e interesuara ..." (neni 33/pika b).

- *Qasja, trajtimi dhe interpretimi i fakteve nga ana e të ftuarve dhe gazetares pasqyrojnë kompetencat editoriale të medias dhe lirisë profesionale të gazetarit dhe për pasojë në mbrojtjen e ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, sipas të cilit "veprimtaria e transmetimeve audiovizive është e lirë" (neni 4, pika 1/a).*

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në cilësinë e autoritetit rregullator në përmbushje të detyrimeve që ngarkon ligji (neni 18 "Objektivat e veprimtarisë së AMA-s", pika 1/b) "AMA, në ushtrimin e funksioneve të veta, siguron: ruajtjen dhe mbështetjen e vlerave demokratike të përcaktuara në Kushtetutë, veçanërisht lirinë e shprehjes dhe të medias, nuk konstatoi shkelje të Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 60 datë 10.07.2023.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Shoqata NAREA	Portale	Njoftime	12.12.2023

1. Objekti i Ankesës

Përfaqësuesit e shoqatës "Narea" i dërguan një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) me pretendimin se disa portale online zhvillojnë praktika abuzive në tregun e Pasurive të Paluajtshme. Ankuesi evidentonte portalet, si "Njoftime.al, Merrjep.al, Njoftime.com, Mirlir.com etj. të cilat publikonin listime të ndryshme të Pasurive të Paluajtshme, pa u identifikuar në shkëlqje të parashikimit të Ligjit

Nr.9/2022 datë 27.1.2022 "Për Profesionin e Ndërmjetësit të Pasurive të Paluajtshme"...".

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pasi mori ankesën evidentoi se ankuesi i referohej portaleve online Njoftime.al, Merrjep.al, Njoftime.com, Mirlir.com të cilat bien jashtë juridiksionit dhe objektit të veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive, (neni 2 "Fusha e zbatimit").

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
G.M	-	-	12.12.2023

1. Objekti i Ankesës

G.M i dërgoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) me pretendimin se "në datën 05.12.2023 po shfaqej një film në ambientet e një karburanti ... Yrshek, ku personazhi kryesor i këtij filmi isha unë...". Ankuesi kërkoi marrjen e masave për ndalimin e realizimit të këtij filmi.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pasi mori ankesën, evidentoi se ankuesi i referohej një materiali të pa publikuar.

Bazuar në ligjin nr.97/2013 "Për mediat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, (neni 2 "Fusha e zbatimit"), ankesa binte jashtë juridiksionit dhe objektit të veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.L	-	-	14.12.2023

1. Objekti i Ankesës

E.L i dërgoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) me pretendimin se *"dispononte me mijëra faqe dokumentacion që janë përgjithësisht çështje penale të nivelit maksimal përsa i përket të dyshuarve për vepra penale"*.

Ankuesi kërkonte nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, që mediat t'i jepnin hapësirë transmetimi audioviziv.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pasi mori ankesën evidentoi se objekti i saj ishte jashtë fushës së veprimit të AMA-s, bazuar në ligjin nr.97/2013 "Për mediat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, (neni 2 "Fusha e zbatimit").

Sakaq, i solli në vëmendje ankuesit se AMA, në cilësinë autoritetit rregullator në fushën e medias audiovizive, respekton kompetencat editoriale të medias dhe lirisë profesionale të gazetarit, të cilat janë në mbrojtjen e ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, sipas të cilit "veprimtaria e transmetimeve audiovizive është e lirë" (neni 4, pika 1/a).

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
B.Sh	Top Channel	"Ftesë në 5"	20.12.2023

1. Objekti i Ankesës

B.Sh i dërgoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) me pretendimin se *"te emisioni i Top Channel apo emisioni i Bietës, Doktor Profesori F.D bashkë me dy fëmijë ka imituar historinë time ne fëmijëri"*.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, e sqaroi ankuesin për fushën e veprimit të legjislacionit të medias si dhe i kërkoi atij plotësimin e të dhënave për vijimin e shqyrtimit të mëtejshëm të problematikës.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
B.Sh	-	-	21.12.2023

1. Objekti i Ankesës

B.Sh i dërgoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) me pretendimin se po kërcënohej me jetë nga ish kompania ku punonte.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, e sqaroi ankuesin për fushën e veprimit të legjislacionit të medias dhe se trajtimi i saj del jashtë tagrit të autoritetit.

the 1990s, the number of people with a mental health problem has increased in the Netherlands. The prevalence of mental health problems in the Netherlands is estimated to be 15% (Van Tilburg *et al.* 2000). The prevalence of mental health problems is expected to increase in the future because of the ageing of the population (Van Tilburg *et al.* 2000).

People with a mental health problem are often dependent on others for their daily needs. This dependency is often caused by cognitive and/or physical impairments. People with a mental health problem often have a low income and are often dependent on others for their daily needs. This dependency is often caused by cognitive and/or physical impairments. People with a mental health problem often have a low income and are often dependent on others for their daily needs. This dependency is often caused by cognitive and/or physical impairments.

People with a mental health problem often have a low income and are often dependent on others for their daily needs. This dependency is often caused by cognitive and/or physical impairments. People with a mental health problem often have a low income and are often dependent on others for their daily needs. This dependency is often caused by cognitive and/or physical impairments.

People with a mental health problem often have a low income and are often dependent on others for their daily needs. This dependency is often caused by cognitive and/or physical impairments. People with a mental health problem often have a low income and are often dependent on others for their daily needs. This dependency is often caused by cognitive and/or physical impairments.

People with a mental health problem often have a low income and are often dependent on others for their daily needs. This dependency is often caused by cognitive and/or physical impairments. People with a mental health problem often have a low income and are often dependent on others for their daily needs. This dependency is often caused by cognitive and/or physical impairments.

People with a mental health problem often have a low income and are often dependent on others for their daily needs. This dependency is often caused by cognitive and/or physical impairments. People with a mental health problem often have a low income and are often dependent on others for their daily needs. This dependency is often caused by cognitive and/or physical impairments.

People with a mental health problem often have a low income and are often dependent on others for their daily needs. This dependency is often caused by cognitive and/or physical impairments. People with a mental health problem often have a low income and are often dependent on others for their daily needs. This dependency is often caused by cognitive and/or physical impairments.

People with a mental health problem often have a low income and are often dependent on others for their daily needs. This dependency is often caused by cognitive and/or physical impairments. People with a mental health problem often have a low income and are often dependent on others for their daily needs. This dependency is often caused by cognitive and/or physical impairments.